

Busulla ideologjike e Kosovës

Evolucioni i orientimit
partiak 2014-2020,
Vlerat dhe Popullizmi



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Instituti Demokraci
për Zhvillim

Seria:
Partitë Politike

Nr. 15

Prishtinë,
Dhjetor 2020

Busulla ideologjike e Kosovës

Evolucioni i orientimit
partiak 2014-2020,
Vlerat dhe Popullizmi

Instituti Demokraci
për Zhvillim

Seria:
Partitë Politike

Nr. 15

Prishtinë,
Dhjetor 2020

Copyright © 2020. Demokraci për zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citate të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikës dhe shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem arkivimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Studimi është përgatitur nga Instituti D4D.

Ky studim është mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer, Zyra në Kosovë. Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

Përmbajtja

Përmbledhje	7
I. Hyrje	9
Qëllimi dhe konteksti	9
Metodologjia	11
II. Qëndrimi i qartë konsolidon demokracinë	13
III. Ndikimi i popullizmit në Kosovë	17
IV. Orientimi ideologjik njëdimensional dhe qëndrimet e partive për problemet specifike	18
Paraqitja e të gjitha temave njëkohësisht	47
V. Shpërndarja e përgjigjeve	50
VI. Kategorizimi i partive	54
VV	55
LDK	58
PDK	61
AAK	64
VI. Sa janë homogjene partitë?	67
Përfundime dhe rekomandime	70
Rekomandime	72
Referencat	72

Përmbledhje

Gjatë verës së vitit 2020, D4D ka realizuar një studim të opinioneve të zyrtarëve partiakë në Kosovë, duke matur kështu opinionet për 40 tema të ndryshme, të cilat janë përdorur për të vlerësuar orientimin ideologjik të katër partive kryesore në Kosovë.

Gjetjet janë se partitë nuk kanë pësuar lëvizje të mëdha. PDK dhe LDK mbesin parti të qendrës lehtë në të djathtë. Lëvizje të vogla kanë shënuar VV dhe AAK, të cilat kanë lëvizur në të djathtë dhe në të majtë. Para gjashtë viteve VV ishte parti mjaft e majtë dhe AAK ishte mjaft e djathtë dhe tani gjenden në pozicion identik. Në përgjithësi, dallimet në mes të partive nuk janë të mëdha.

Shpesh më të mëdha janë dallimet brenda partive dhe kjo dëshmon se zyrtarët nuk i janë bashkuar një partie për shkak të qëndrimeve të saj në temat të politikave publike konkrete si këto që masim ne. Afërsia e aktivistëve ndaj një partie ka të bëjë më tepër me faktin që një i afërm i tyre është anëtar apo vendimmarrës në atë parti, apo për shkak të afinitetit gjeografik, apo në të kaluarën edhe për shkak të pozicionimit gjatë luftës, apo qëndrimeve ndaj dialogut dhe Serbisë.

Studimi i ri tregon se tërë skena politike ka lëvizur drejt qendrës (nga e majta dhe nga e djathta). Shumica (2/3 për tri parti përveç LDK-së akoma mbesin në kuadrantin statist (konservatorë të majtë). Pothuaj nuk ekziston asnjë konservativ sa i përket vlerave dhe i djathtë sa i përket parimeve ekonomike. Shumica e një të tretës së mbetur, të cilët janë më të hapur sa i përket vlerave të tyre personale, po ashtu besojnë në ekonominë e tregut të lirë. Përshkrimi i mësipërm vlen për LDK, PDK dhe AAK përderisa Vetëvendosje është e majtë sa i përket ekonomisë, konservative në çështjen e identitetit dhe liberale për liritë personale. Kjo tregon qartë se politikat konkrete publike nuk janë përcaktuese për orientimin e partisë dhe se partitë përbrenda janë po aq të larmishme sa janë edhe kur krahasohen me të tjerat.

Tutje, nëse vendosen të gjitha partitë së bashku në një grafikon, nuk dallohen ithtarët e njëjës nga të tjetrës. Nga ky punim shihet se ka shumë bashkëmendimtarë të cilët janë në parti të ndryshme. Nëse do t'i kishim ndarë zyrtarët sipas mendimeve, do të mund të rikompozim 4 parti homogjene. Në një vend me qëndrime parimore, partitë do të ishin bërë më homogjene për shkak të përafrimit të aktivistëve që kanë mendime të ngjashme.

Nuk është për t'u befasuar që partitë e formuara gjatë përpjekjeve për çlirim kombëtar nuk shfaqin ideologji të definuar qartë. Gjatë periudhës nën administrim ndërkombëtar, elitat politike nuk kanë zhvilluar qëndrime të qarta për çështje të rëndësishme shoqërore. Me kalimin e kohës, Kosova ka marrë përgjegjësi më të mëdha në qeverisjen e saj, që i imponon elitës politike të ketë qëndrime më të qarta për temat nga të cilat sfidohen. Pozicionet dhe opinionet e ndryshme ballafaqojnë politikë-bërësit përballë njëri-tjetrit brenda dhe përtej vijave partiake – duke krijuar kështu një stimul shumë të rëndësishëm për transformimin aq të nevojshëm.

Identifikimi i ideologjive të partive është shumë i vështirë në një shoqëri të sapodalë nga lufta e cila ende është duke bërë përpjekje për të plotësuar nevojat bazike dhe për të konsoliduar sovranitetin e saj. Përderisa vendi ballafaqohet me çështje të cilat shihen si ekzistenciale, pozicionimi për tema tjera duket si çështje luksi.

Para 6 viteve, Instituti D4D kishte krijuar një vegël studimore me të cilën kishte matur ideologjinë e partive dhe tani përsërit të njëjtin studim me të njëjtën metodologji, për të vlerësuar nëse ka pasur lëvizje të sentimentit politik. Përderisa botimi i parë ka bërë skanim të gjendjes, botimi i dytë vlerëson evolucionin e këtyre mendimeve.

Është e natyrshme që nga çlirimi i vendit partitë dalin të ngjashme në aspektin ideologjik. Varet nga dinamika e periudhës së pasluftës nëse qeverisja dhe politika sjellin ritëm me të cilin fillon përafrimi me simotrat e tyre evropiane. Transicioni ka nënkuptuar një inercion të narracionit të pasluftës dhe shpërndarje lokaliste të të mirave publike. Gjatë konsolidimit të demokracisë, disa parti transformohen, disa shuhen, shfaqen parti të reja – një proces i vazhdueshëm derisa secila prej tyre të arrijë të përfaqësojë një elektorat stabil më të gjerë, të cilin nuk e lidh aspekti gjeografik por brengat dhe shqetësimet e njëjta.

Në ato pak raste kur partitë kanë shfaqur tipare ideologjike, ato nuk kanë qenë asgjë më shumë sesa vetë-emërtime. Aspiratat e tyre gjithnjë e më shumë pasqyrojnë preferencat për t'iu bashkuar ndonjë grupi të partive pan-evropiane, e pak kanë të bëjnë me bindjet e anëtarëve të tyre.

I. Hyrje

D4D ka kryer një studim të ngjashëm para 6 viteve që u bë mbase një ndër përpjekjet më të rëndësishme për të analizuar orientimin ideologjik të skenës politike. Studimet e mëhershme kishin bërë disa përpjekje të kodifikojnë profilet ideologjike të partive politike në Kosovë kryesisht duke u bazuar në vetë-deklarimet e partive si e shohin veten. Studime më të thella nuk ishin bërë dhe analistët dyshonin se vetë-deklarimi shpërfaq saktë identitetin e partisë. Gjithashtu qëndrimet për çështje konkrete shpesh nuk përputheshin me identitetin e proklamuar nga partitë.

Si para 6 viteve, ashtu edhe sot, mbetet sfida se partitë nuk kategorizohen lehtë sepse shpërfaqin qëndrime mjaft diverse. Mbetet e rëndësishme për të matur në çfarë mase identiteti i proklamuar nga lart vërtetë ka depërtuar te strukturat e partisë që janë në pozita vendimmarrëse edhe pse identiteti nga poshtë-lart do të ishte më organik.

Në këtë fazë të zhvillimit të partive, deklarimi i kreut të subjektit apo anëtarësia në aleanca mbarë-evropiane shfaq një vullnet se ku mëton lidhshipi që ta shpie subjektin. Nëse nuk sfidohet nga anëtarësia apo kryesia, ky rreshtim mund të merret si cak kolektiv edhe nëse nuk pasqyron realitetin aktual. Debati publik në Kosovë kryesisht dominohet nga temat politike të ditës (dialogu, vizat, polarizimi në mes të liderëve) dhe mungesa e diskutimit të temave konkrete socio-ekonomike lë të paqartë se deri në çfarë mase partitë kuptojnë se çfarë nënkupton ky orientim për një gamë temash konkrete.

Nuk dihet nëse anëtarësia mendon njëzëri me lidhshipin për tema për të cilat nuk diskutohen në publik dhe për të cilat partitë nuk kanë qëndrime. Në këtë fazë të evoluimit të demokracisë, mbase profili i diktuar nga lart nuk është i dëmshëm dhe përbën fillin e këtij procesi. Partitë akoma nuk kanë zhvilluar as mekanizma efektivë të demokracisë së brendshme, nuk janë ballafaquar sa duhet me tema të cilat imponojnë qëndrime të qarta ideologjike dhe vazhdojnë të udhëhiqen nga grupe të vogla të zyrtarëve. Fundja, profilizimi i qartë akoma sfidon vende me traditë më të gjatë se Kosova.

Qëllimi dhe konteksti

Me kategorizimin e mendimeve partiake për mbi 40 tema socio-ekonomike, ky punim ka dy qëllime kryesore. Punimi mëton t'u ndihmojë partive politike për të reflektuar për qëndrimet e tyre për tema të ndryshme konkrete, duke vlerësuar nëse kanë koherencë të brendshme dhe qëndrim të qartë. Nëse partia ka koherencë të brendshme, atëherë këtë qëndrim edhe mund ta shfaqë haptazi, që zakonisht nuk është tipar i partive tona. Së dyti, punimi mëton ta informojë publikun dhe shoqatat që përfaqësojnë qytetarë me

interesa të ngjashme që të vlerësojnë se cila nga partitë politike është më e afërt me interesat e tyre.

Partitë nuk duket se kanë ndonjë shtytje të organizuar për të marrë qëndrime të qarta për tema kundërthënëse e aq më pak që të përkufizojnë ideologjinë. Madje për shkak të krizave të nëjpasnjëshme politike, edhe vetë-deklarimet të cilat më parë ishin pjesë të diskursit kanë pushuar. Kosova duhet të presë për një dinamikë tjetër politike, mbase pas dialogut me Serbinë që udhëheqësitë politike të përpiqen që të shndërrojnë emërtimin ideologjik në udhëzim konkret për pozicionim rreth temave konkrete.

Edhe kur të rikthehet debati i orientimit, nuk do të varet vetëm nga lidhshipi, por nga qëndrimet reale të zyrtarëve me ndikim. Prandaj ky studim mëton të analizojë mendimet e një rrethi më të gjerë të zyrtarëve dhe aktivistëve në parti. Qëndrimet dhe ndryshimi i tyre me kohë është me rëndësi për të kuptuar transicionin dhe transformimin gradual të partive – nga të qenit mjete të grupeve që kanë themeluar partitë drejt përfaqësimit të një baze stabile të votuesve me interesa të përbashkëta dhe jo gjeografikisht të koncentruara.

Një profil i dallueshëm dhe konsistent i partisë do të jepte edhe orientim të efektshëm dhe të kontribuojë drejt disiplinimit të partisë. Në çdo vend me demokraci të re, legjitimiteti buron prej liderëve, veçanërisht kur ata janë vetë themeluesit e tyre. Por me kalimin e kohës, vdesin disa nga liderët, apo largohen nga politika, dhe zyrtarë të tjerë me ndikim ndërrojnë partitë, dhe liderë të rinj, pa peshën politike të të qenit themelues, mbushin vakumin e krijuar. Me kalimin e viteve, edhe votuesit që mbajnë mend partinë për shkak të emrit të mitizuar të themeluesit, vdesin dhe në vend të tyre, të rinjtë arrijnë moshën për të votuar. Të rinjtë pastaj kanë kritere më praktike se për kë do të votojnë.

Partive u leverdis definimi edhe për arsye se kalimet nga një parti te tjetra bëhen më të rralla. Tani lehtësisht kalon një aktivist sepse lidhja është me liderin – dhe lehtë demoralizohet një aktivist dhe mund të personalizojë raportin me udhëheqësinë. Kjo edhe është një nga arsyet pse Kosova ka politikë kaq të polarizuar, sepse politika bëhet personale.

Një individ i cili i mbron, të themi, politikën i lirisë individuale vështirë se mund t'i bashkohet një partie e cila nuk i përshtatet qëndrimeve të tij/saj. Përderisa ideologjia do ta forconte disiplinën e partisë, konsistenca e mendimeve mund ta kufizojë lirinë e veprimit të udhëheqësve individualë dhe do ta forconte demokracinë e brendshme partiake.

Duke e pasur parasysh evoluimin gradual të partive politike në Kosovë dhe kalimet e shumta nga një parti në tjetrën, kjo periudhë përbën një fazë ideale për analizë më të hollësishme të çështjeve dhe për të krijuar një pasqyrë më të saktë të opinionit të personave më me ndikim.

Hipoteza jonë fillestare ishte se mesatarja e koordinatave ideologjike brenda secilës parti nuk dallon shumë nga një parti në tjetrën. Partitë janë pragmatike prandaj shpërndarja e individëve luhet nëpër spektrin

ideologjik – prandaj nuk ka mbështetje për ndonjë pozicion për çështje të veçantë politike. Në raste kur partitë politike proklamojnë një emërtim apo cilësim ideologjik, ato më shumë e pasqyrojnë dëshirën e krerëve të tyre më të lartë se si dëshirojnë që të shihet partia e tyre nga jashtë.

Metodologjia

Pas studimit të thellë të ideologjive në vendet tjera, studimi i parë kishte krijuar vegël enkas për Kosovën. Orientimi ideologjik është specifik në çdo vend dhe nuk mund të përdoret vegël standarde. Atëbotë u përpilua një pyetësor i përshtatur për këtë qëllim i cili është përdorur për të intervistuar mbi zyrtarë të lartë të katër partive kryesore.

Metodologjia fillestare u zhvillua për klasifikimin e përcaktimit ideologjik, përmes zhvillimit të anketave për mbledhjen e opinioneve të 40 zyrtarëve të lartë të secilës prej katër partive kryesore. Pyetësori nuk parashtrroi pyetje të hapura për prirjet ideologjike, por i parashtrroi 40 pyetje specifike për një varg çështjesh. Secila përgjigje përkon me një sistem të pikëve, e cila pastaj paraqitet në një diagram.

Për secilën pyetje janë paraqitur disa opsione si përgjigje. Më pas, pyetjet (si dhe përgjigjet) janë modifikuar për t'iu përshtatur kontekstit të Kosovës. Secilës përgjigje të mundshme i është caktuar një vlerë numerike, nga -10 (shumë majtist ose konservator) deri në +10 (i djathtë ose liberal).

Janë realizuar rreth 100 intervista me zyrtarë të mesëm dhe të lartë të katër partive politike (VV: 24; LDK: 21; PDK: 21; AAK: 24). Do të ishte ideale që mostra të jetë sa më e madhe, por kushtet e pandemisë e kanë bërë këtë të vështirë. Në të ardhmen, projekti mund të përsëritet duke gjetur mënyra për të realizuar numra më të mëdhenj të mostrës e mbase edhe të bëhen krahasime më të detajuara brenda secilit subjekt varësisht nga moshja, lokacioni etj. Ishte paraparë që të intervistohen edhe zyrtarët dhe aktivistët e NISMA por bashkëpunimi nuk ishte i mjaftueshëm për të arritur një masë kritike minimale të pyetësorëve.

Përgjigjet ndaj anketës shërbyen si udhëzues për t'i vendosur aktivistët e partive kosovare në spektrin ideologjik. Numrat që i korrespondojnë secilës përgjigje u kodifikuan në diagram, duke u bazuar në vlerën mesatare numerike të rezultateve të tyre. Shuma e përgjigjeve të secilit pjesëmarrës në anketë u përmbledh në një rezultat të përgjithshëm, i cili po ashtu u paraqit në diagram. Ky prezantim na ndihmoi që ta përkufizojmë ideologjinë e secilës parti politike, së pari për secilën çështje (shih diagramet një-dimensionale) si dhe për partinë në tërësi.

Pas 6 viteve është përdorur i njëjti pyetësor. Edhe pse disa pyetje mund të jenë më pak aktuale, relevanca kryesore e studimit është pikërisht tani kur mund të krahasojmë trendin nga një distancë kohore.

Metodologjia në detaje është shpjeguar në studimin e parë, dhe këtu do të shpjegohet shkurtimisht. Meqenëse jo të gjitha pyetjet kanë rëndësi të njëjtë, secilës pyetje i është vendosur një peshë e caktuar e cila ishte diskutuar me mbi 30 ekspertë të fushave të ndryshme.

Përgjigjet për secilën pyetje kontribuuan për matjen e koordinatave të secilit pjesëmarrës përgjatë secilit prej dy boshteve, atij ekonomik (boshti horizontal) dhe politiko/social (boshti vertikal). Në botimin e parë mund të gjendet lista e pyetjeve me peshën e cila është përdorur për të kalkuluar pikët për grafikonët e partive politike.

II. Qëndrimi i qartë konsolidon demokracinë

Periudha historike kur u themeluan shumica e partive politike në Kosovë përkon me procesin e çlirimit dhe të shtet-ndërtimit. Supozimi ka qenë se me arrijtjen e pavarësisë, Kosova do t'i kthehet agjendave zhvillimore. Por, Serbia vazhdon të kontestojë pavarësinë, duke parandaluar njohjen nga shumë shtete. Rrjedhimisht, një nga prioritetet më të mëdha vazhdon të jetë konsolidimi i sovranitetit, duke bërë që politika të vazhdojë të përqendrohet rreth disa prioritetëve ekzistenciale. Studimi i kaluar konkludoi se”

“Kjo mungesë e identitetit ideologjik mund të shpjegohet vetëm duke e pasur parasysh faktin se partitë politike në Kosovë u themeluan gjatë përpjekjeve për çlirim. Partitë u formuan prej grupeve të cilat ishin mobilizuar gjatë luftës ose rezistencës, dhe të cilat i bashkonte gjeografia, profesioni ose lidhja familjare.”

Kosova është duke zhvilluar traditën e saj demokratike dhe një pjesë e madhe e procedurave janë krijuar. Por thellimi i demokracisë vështirë vie vetëm nga procedurat sepse kërkon internalizim të logjikës së demokracisë si pjesë e përditshmërisë por edhe kur procedurat tregohen të vlefshme në momente të rëndësishme. Opozita e shihet se detyrë e saj është të jetë kundër qeverisë, pa marrë parasysh cilësinë e vendimeve. Qeveria kërkon të ketë numra të mjaftueshëm për ta mundur opozitën, rrjedhimisht partitë politike nuk përpjekin të arrijnë konsensus pavarësisht se sa është e rëndësishme çështja në rend të ditës. Polarizimi, bllokimi dhe krizat politike janë thelluar tutje dhe shumica parlamentare shpesh mbështetet te partitë shumë të vogla për të siguruar numrat të cilat kanë sjellë cilësi të dobët të ministrave.

Ka shumë arsye pse një individ i bashkohet një partie – afërsia me liderin, gjasat që partia të fitojë zgjedhjet - por afërsia me programin (dhe nëse ka mendim të njëjtë për çështje të politikave publike) akoma nuk është rëndom arsye primare. Preferencat e votuesve për çështjet madhore nuk u komunikohen si duhet partive politike, gjë që nuk i shtyn partitë që të krijojnë platforma të qarta.

Rruga e zhvillimit të partive të Kosovës për krijimin e konsistencës në qëndrimet e veta lidhet ngushtë me rrugën e politikës së Kosovës drejt modernizimit. Me përmbushjen e nevojave themelore (për rrugë, ujë, kanalizim), premtimet që kosovarët e zonave rurale presin të përmbushen janë më pak të lidhura me kufijtë gjeografikë. Të menduarit e njëjtë që i lidh kosovarët e rinj kanë të bëjnë me profesionin, gjininë, hobin, përkatësinë etnike ose grupmoshën. Kjo ia hap rrugën secilit deputet që të synojë

votuesit e profileve specifike në tërë Kosovën, e cila mundësohet nga fakti se Kosova është një zonë e vetme zgjedhore.

Punimi tutje erdhi në përfundim se:

“Partitë mbledhin rreth vetes një pjesë të barabartë të individëve me prirje majtiste, liberale, ose nacionaliste, sepse këto anime nuk ishin fare kriter për përafrimin e tyre fillestar. Shumica e partive u themeluan para se vendi ta kishte një regjim demokratik e gjithashtu para se të fillojnë të paraqiten grupe të dallueshme socio-ekonomike, të cilat bashkohen për të mbrojtur një interes mirë të definuar në kutitë e votimit apo në legjislaturë”

Deri vonë, politikanët në masë të madhe janë bazuar në marrjen e votave nga një zonë e caktuar gjeografike, duke pasqyruar një lojalitet ndaj strukturave që bazohen në miqësi dhe lidhje familjare. Megjithatë, është me rëndësi të identifikohen veçoritë e kulturës politike që do të mund të nxisinin votuesit të identifikojnë politikanët që ndajnë mendim të njëjtë me ta pavarësisht prejardhjes së tyre gjeografike.

Zhvillim evolutiv drejt profilizimit të partive politike tutjeu vonua edhe më shumë për shkak se kosovarët nuk e qeverisën vendin në pjesën më të madhe të periudhës së pasluftës. Për një kohë të gjatë Kosova u administrua nga bashkësia ndërkombëtare, gjë që privoi elitën politike nga qeverisja e vendit – dhe kjo mospjesëmarrje në qeverisje i kurseu politikanët e zgjedhur vendorë nga nevoja për t'u pozicionuar për çështje specifike politike.

Studimi i para 6 viteve mëtonte që të plotësojë studimet e mëparshme me një segment të ri. Për të plotësuar pikërisht boshllëkun e identifikuar më lart, studimi bëri matje të mendimeve të individëve me ndikim brenda secilës parti. Supozimi ishte se shpërndarja kolektive e mendimeve paraqet një tregues më real se ku qëndron një parti politike, dhe çfarë trendi të votimit mund të pritet të kenë përfaqësuesit e tyre në legjislaturë.

Krijimi i profilit të partisë lidhet ngusht me një proces tjetër, atë të zhvillimit të grupeve të interesit, përderisa tradicionalisht politikanët e Kosovës kanë fituar përkrahjen në rajone gjeografike që lidhet me nevojat bazike të papërmbushura, punësimin dhe nepotizmin si tri fenomenet kryesore që ndërlidhen me politikën lokale. Me konsolidimin e demokracisë dhe avancimin e medias, kandidatët mund të rrisin përkrahjen duke apeluar në

qëndrime parimore dhe jo vetëm në përkrahje specifike gjeografike.

Grupet e shpërndara gjeografikisht (p.sh. shoqata e të verbërve, etj) duhet të llojnë tek aktivistët e partive për të realizuar qëllimet e tyre. Meqë ata zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvend të cilët i shprehin prioritetet e tyre, po ashtu mund të pritët që politika në Kuvend, në zyrat e partive politike dhe në prapaskena të fillojë të përfaqësojë grupet kryesore të votuesve. Gjetjet e paraqitura në këtë raport ndihmojnë që të kuptohet më mirë shkalla e afërsisë së opinioneve dhe mund të inkurajojnë partitë të jenë më eksplicite në qëndrimet të cilat mbrojnë.

Me qeverisje gjithnjë më të pavarur, vendimmarrësit duhet të marrin vendime për çështje të vështira, gjë që i detyron ata që të jenë më të qartë sa i përket pozicioneve të tyre për çështje të caktuara. Sa më shumë çështje me të cilat ballafaqohet vendi, aq më e lehtë bëhet që të vërehet nëse vendimet janë koherente me kalimin e kohës.

Një nga arsyet e këtij studimi është se qartësimi i profilit ideologjik nxit qeverisje më të mirë si dhe rrit konkurrencën brenda dhe përtej linjave partiake.

Qëndrimet e qarta domosdo nxjerrin në shesh dallimet e brendshme dhe inkurajojnë kalimet përtej vijave partiake. Një seri e tillë e transfereve parimore mund të inkurajojë transformimin aq të nevojshëm të skenës politike, ku miqësia më nuk shërben si ngjithës për të mbajtur partitë politike së bashku por kjo zëvendësohet me konsistencën politike. Sa më shumë parti dhe individë që e shprehin mendimin e tyre, që votojnë në kuvend, që deklarohen haptazi për çështje të ndryshme, eventualisht largohen nga një parti për t'iu bashkuar tjetrës, sa më shumë parti të reja që formohen, votues të rinj që vendosin vet se cilës parti t'i bashkohen, aq më shumë mund të themi se ka ndodhur njëfarë shkalle e transformimit (botimi i parë).

Skena jonë politike është konsumuar kryesisht nga dialogu dhe integrimi në BE, që të dyja procese që nuk inkurajojnë dallimet ideologjike. E para ka të bëjë me çështje ekzistenciale në ndërtimin e shtetit dhe e dyta si proces që shihet si mjaft teknik dhe me të arritura konkrete të cilat nuk i nxjerr debati vendor por ku duhet lëvizur drejt caqeve paraprakisht të përcaktuara nga BE. Perceptimi është integrimi evropian është relativisht teknik dhe ligjet “nuk kanë nevojë për debat pasi që edhe vendet e përparuara evropiane tashmë e kanë marrë vendimin e njëjtë”

Niveli i ulët i zhvillimit dhe dëshira për përparim drejt BE-së gjithashtu paraqesin arsye për mosprofilizim të hershëm ideologjik për shkak se

krijohet përshtypja se zhvillimi ka një drejtim të caktuar dhe se nuk ka hapësirë për mundësi të ndryshme të cilat kërkojnë debat dhe pozicionim. Botimi i kaluar kishte përfunduar:

“Duket se një numër gjithnjë e më i madh i zyrtarëve të zgjedhur po e kuptojnë nevojën që t'i riformulojnë prioritetet e tyre kryesore dhe t'i ruajnë votuesit e vet në bazë të zgjidhjeve politike që i bëjnë. Partitë me objektiva të mirëfillta (qoftë me konsistencë ideologjike ose jo) do t'i përkrahnin interesat e grupeve të caktuara për dallim nga politikat sporadike që me siguri i shtyjnë përpara interesat e udhëheqësve të partive dhe rrjeteve të tyre klanore. Partitë mund të rriten dhe të fitojnë votues të rinj nëse ua bëjnë më të lehtë votuesve që t'i mbajnë përgjegjës përfaqësuesit e tyre për performancën në zbatimin e këtyre politikave.”

Demokracia e Kosovës duhet të avancojë në mënyrë që një deputet të japë llogari më shumë votuesve sesa kreut të partisë së vet. Grupet e ngushta të interesit shpesh ndihmojnë zgjedhjen e deputetëve, por kur grupet e gjëra të interesit, që kanë anëtarë gjithandej, kanë deputetin e vet, me këtë kjo shpie në mbrojtjen më të madhe të interesave e qytetarëve. Një komunikim më dinamik mes shoqatave të organizuara mirë dhe deputetëve me pozitë specifike mund ta përmirësojë cilësinë dhe pjesëmarrjen në zhvillimin e politikave.

Kjo dinamikë funksionon vetëm nëse profili ideologjik është i qartë dhe si rrjedhojë, partitë politike do të jenë më të përgjegjshme për çështjet e ndryshme dhe ndaj grupeve të caktuara të votuesve.

Pjesa në vijim e bën një krahasim të përgjigjeve të partive për 40 tema specifike të cilat edhe përdoren për të paraqitur orientimin e partive në diagram në kapitullin tjetër. Risia e këtij botimi është edhe analiza e shpërndarjes së përgjigjeve (me devijimin standard) dhe analizë të mesatares jo vetëm të partive por të tërë spektrit politik.

III. Ndikimi i popullizmit në Kosovë

Trajektorja e zhvillimit demokratik në nivel global ka pësuar stagnim përgjatë viteve të fundit. Raportet dhe indeksat ndërkombëtare, përfshirë këtu “Democracy in Retreat” (Freedom House) dhe “Democracy Facing Global Challenges” (Varieties of Democracy Institute, V-Dem) nënvizojnë një trend global të rënies së kualitetit të demokracisë dhe ngritje të iliberalizmit demokratik.

Nga ky fenomen është prekur edhe kontinenti evropian dhe shtetet anëtare të BE-së. Përkeqësimi i kualitetit të demokracisë ka krijuar vakum politik dhe një mundësi për partitë populiste. Si rezultat, Evropa ka përjetuar një valë të re të popullizmit dhe një rikthim në diskursin publik të logjikës së vjetër agresive ksenofobe dhe raciste, por edhe të retorikës 'anti-elitë' dhe 'anti-sistem' duke lëkundur kështu themelet e demokracisë evropiane.


Popullistët krijojnë polaritet në shoqëritë e tyre duke krijuar ndasi të theksuara mes “popullit” dhe “elitave”, dhe i atribuojnë vetes të drejtën për të folur në emër të popullit. Sipas Cas Mudde, autor i librit “Populism: A Very Short Introduction”, popullizmi përkufizohet mbi idenë se shoqëria është e ndarë në dy grupe të cilat janë në kundërshtim me njëra-tjetrën: 'njerëzit e pastër' dhe 'elita e korruptuar'.²

Megjithatë, qasja e popullistëve nuk është çdo herë e njëjtë. Popullizmi është karakteristikë e shumë subjekteve politike, mirëpo është më tepër e theksuar në ekstremin e majtë dhe të djathtë. Popullistët e majtë fokusohen më tepër në problemet socio-ekonomike siç janë varfëria dhe pabarazia, ndërsa popullistët e djathtë në konceptet socio-kulturore siç janë nacionalizmi, religjioni dhe imigracioni. Një faktor krahasimor dhe determinues është fakti se popullistët e djathtë krijojnë ndasi të theksuara në shoqëri, duke bërë thirrje për shtete etno-nacionaliste dhe homogjene dhe në të njëjtën kohë duke demonizuar minoritetet etnike dhe religjioze.


Kosova si shteti më i ri në rajon është fragjile ndaj popullizmit. Popullizmi ndikon negativisht duke degraduar diskursin publik të vendit dhe duke krijuar ndarje në shoqëri. Mungesa e profilizimit ideologjik, mungesa e programit të qartë politik, mungesa e demokracisë brenda partisë, nënshtrimi ndaj liderit dhe militantizmit janë disa prej faktorëve të cilat ndikojnë tek elektorati dhe rrjedhimisht Kosova si shoqëri. Gjithashtu, niveli i dobët i edukimit në Kosoë krijon mundësi për partitë politike, të cilat mund të eksploatojnë kriza të ndryshme në vend për avancim politik.

IV. Orientimi ideologjik njëdimensional dhe qëndrimet e partive për problemet specifike

Spektri politik është portretizuar përmes modeleve të ndryshme në kohë të ndryshme, duke filluar nga modeli njëdimensional i krijuar nga Parlamenti i pas Revolucionit të Francës. Thelbi i studimit tonë janë pikërisht diagramet njëdimensionale, duke e përdorur shkallëzimin tradicional ekonomik dhe social. Më poshtë paraqitet modeli social (M kah D, më pak liri individuale deri te më shumë liri individuale) dhe modeli ekonomik (M kah D, ekonomi e kontrolluar deri te kapitalizëm i tregut të lirë).




Një spektër tjetër njëdimensional është modeli ekonomik i marrë nga burimi i njëjtë. Modelet dydimensionale vijnë si kombinim i këtyre dy modeleve, në dy boshte të ndryshme. Pjesa e mbetur e këtij kapitulli krahason mesataret e përgjigjeve nga secila parti sipas pyetjeve specifike, për vitin 2014 dhe të vitit 2020. Mesatarja e secilës parti për vitin 2020 paraqitet me ngjyrë të errët dhe pikë të plotë, përderisa të dhënat e vitit 2014 paraqiten në nuancë më të lehtë dhe pika nuk është e plotë.



Temat ekonomike

Skena politike kosovare në përgjithësi zë vend në anën e majtë të qendrës sa i përket prioriteteve ekonomike dhe fiskale. Vërehet lëvizje në të djathtë e VV-së për temat ekonomike edhe pse akoma mbetet partia më e majtë në spektrin kosovar. Më 2014, AAK ishte partia më e djathtë në temat ekonomike por ka lëvizje të ndjeshme në të majtë. PDK dhe LDK tani janë partitë më të djathta në qëndrimet e tyre.

1. Tregtia e lirë dhe roli i shtetit



Para 5 viteve shumica e përgjigjeve të VV-së silleshin rreth përgjigjes se “autoritetet duhet të rregullojnë tregun në masë të madhe” dhe tani ka lëvizur një përgjigje në të djathtë ku shumica e përgjigjeve tani përqendrohen rreth asaj se autoritetet duhet të rregullojnë tregun në mënyrë domethënëse, një shkallë në të djathtë.


Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Rregullimi i tregtisë	-2.0	-2.7	←

Skena politike kosovare në përgjithësi zë vend në anën e majtë të qendrës sa i përket prioriteteve ekonomike dhe fiskale. Vërehet lëvizje në të djathtë e VV-së për temat ekonomike edhe pse akoma mbetet partia më e majtë në spektrin kosovar. Më 2014, AAK ishte partia më e djathtë në temat ekonomike por ka lëvizje të ndjeshme në të majtë. PDK dhe LDK tani janë partitë më të djathta në qëndrimet e tyre.

Devijimi standard i tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Rregullimi i tregtisë	4.9	5.2	←

Vërehet që tërë spektri politik ka lëvizur paksa në të majtë (nga -2 në -2.7) që është edhe trend global dhe se përgjigjet janë paksa më të shpërndara më 2020.

2. Detyrimet doganore




Një nga pyetjet për të përcaktuar orientimin ideologjik sa i përket ekonomisë ka të bëjë me detyrimet doganore duke pyetur nëse taksa doganore duhet të ngritet, të ulet apo të mbetet e njëjtë. Para 5 viteve, VV favorizonte rritje të lehtë të taksave dhe tani favorizon ruajtjen e tyre në këtë nivel. AAK favorizon rritje të lehtë të taksave përderisa LDK dhe PDK favorizojnë ruajtjen e taksave siç janë tani.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Detyrimet doganore	0.3	0.2	=

Edhe pse ka pasur lëvizje të rezultateve të partive, vërehet se mesatarja e tërë partive ka qëndruar në të njëjtin vend. Përgjigja prej 0.2 është në mes të përgjigjeve se taksa doganore prej 10% duhet të mbetet si është (-1) dhe përgjigjes se taksa doganore të mbetet aq sa është tani por të ulet dikur më vonë (+1).

3. Akciza



Para 6 viteve, zyrtarët e VV-së përkrahnin rritje të akcizave më të larta dhe tani përkrah vetëm përdorimin e tyre për të dekurajuar disa lloje të sjelljes duke vënë akcizë më të lartë. AAK dhe PDK janë më të majtë sesa VV në këtë pikë përderisa LDK edhe pse përkrah përdorim deri diku të akcizës ka edhe hezitime sepse sjell komplikime në kodin e taksave.


Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Akciza	-3.1	-0.9	→

Vërehet që tërë spektri politik ka lëvizur kah e djathta, dmth ku ka përkrahje më të ulët për përdorim të akcizës sesa më parë. Përgjigja prej 0.9 është pak në të majtë të përgjigjes me vlerë 0 që është: "Akciza duhet të përdoret për t'i dekurajuar disa lloje të sjelljes (pirja e duhanit, alkooli)."

Devijimi standard i tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Akciza	5.3	6.7	←

Përgjigjet janë jashtëzakonisht të shpërndara që dëshmon se ka dallime të mendimeve në mesin e respondentëve të subjekteve politike.

4.TVSH




Edhe te përdorimi i TVSH-së ka lëvizje të tërë spektrit në të djathtë, të VV-së nga -2.9 në 0.7, të PDK-së nga -0.1 në 3.7, përderisa LDK dhe AAK kanë lëvizur nga e djathta drejt qendrës. Tani LDK dhe VV janë në të njëjtën vlerë që korrespondon më së afërti me përgjigjen se “shkurtimi i shpenzimeve duhet të përmirësojë ekonominë, por gjithashtu edhe rritja e TVSH-së duhet të merret parasysh” përderisa PDK është më afër përgjigjes se “rritja e TVSH-së do ta dobësojë ekonominë, e cila në anën tjetër do të krijojë një standard më të ulët të jetesës.”

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
TVSH	0.3	1.6	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
TVSH	4.6	3.9	→

Për TVSH mendimi ka lëvizur në të djathtën (1.6) ku gatishmëria për të rritur tutje TVSH-në ka rënë. Tani mesatarja e përgjigjeve është më afër me përgjigjen se rritja e TVSH-së nuk duhet të konsiderohet dhe të ardhurat shtesë duhet të gjenerohen vetëm duke shkurtuar shpenzimet. Mendimet janë përafëruar dhe tani ka më pak dallime në opinione se që kishte para 6 viteve.

5. Krijimi i vendeve të punës




Sa i përket krijimit të vendeve të punës, pothuajse të gjitha partitë është shtuar perceptimi se shteti ka përgjegjësi të ndjeshme për krijimin e vendeve të punës në bashkëpunim me sektorin privat, dhe mund të thuhet se ka lëvizje në të majtë të tërë spektrit politik.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Krijimi i vendeve të punës	-2.2	-3.4	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Krijimi i vendeve të punës	5.1	5.3	←

Të gjitha partitë kanë lëvizur në të majtë dhe më së shumti ka lëvizur VV, pasuar nga LDK, PDK dhe AAK.

6. Paga minimale




Edhe sa i përket pagës minimale ka lëvizje të tërë spektrit politik në të majtë. Për LDK-në, VV-në dhe AAK-në, paga minimale duhet të jetë e barabartë me ato të vendeve fqinje dhe të vlejë për sektorin publik. PDK është për një pagë minimale që siguron jetë të mirë për sektorin publik dhe privat, për një nuancë më afër qendrës në krahasim me partitë tjera.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Paga minimale	-3.7	-6.7	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Paga minimale	4.5	4.9	←

Për pagën minimale spektri politik ka lëvizur në të majtë me gatishmëri për pagë minimale më të lartë. Gjithashtu, llojshmëria e përgjigjeve është rritur.

7. Sindikatat




VV akoma favorizon sindikata të fuqishme të cilat mund të negociojnë në emër të anëtarëve të tyre si në sektor publik edhe në atë privat. LDK dhe PDK përkrahin sindikata të fuqishme për sektorin publik, përderisa AAK përkrah sindikata të fuqishme për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e punëtorëve në vendin e punës dhe është më afër qendrës në krahasim me partitë tjera.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Sindikatat e punëtorëve	-4.2	-4.1	=

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Sindikatat e punëtorëve	4.4	3.4	→

Opinionet për sindikatat janë pothuajse të njëjta tani si para 6 viteve (nga -4.2 në -4.1). Mesatarja e përgjigjeve tani është më së afërti përgjigjes (-4) që thekson se “sindikata mjaft të forta të punës për të negociuar në emër të anëtarëve të tyre, vetëm për sektorin publik”. Tani ka edhe më pak divergjenca në përgjigje të cilat janë më homogjene jo vetëm sa i përket mesatares por edhe shpërndarja e përgjigjeve është më e vogël.

8. Tatimet e sheshta apo progresive?



Subjektet kanë lëvizur në të djathtë drejt tatimit të sheshtë në përgjithësi (nga -2.3 në -0.1). VV akoma përkrah tatim progresiv përderisa LDK dhe PDK përkrahin tatim të sheshtë.


Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Tatimi i sheshtë apo progresiv	-2.3	-0.1	→

Mesatarja prej 0.1 është në mes të përgjigjes (-1) se tatime më të larta duhet të vendosen mbi të pasurit për të ruajtur një ekonomi stabile, dhe përgjigjes (+1) se taksat më të ulëta për të varfrit mund të dobësojnë ekonominë.

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Tatimi i sheshtë apo progresiv	4.4	3.4	→

Shpërndarja e përgjigjeve individuale ka rënë që do të thotë se gradualisht është duke u krijuar një opinion i etabluar.

9. Privatizimi



Vetëvendosje vazhdon të ketë qëndrim kundër shumicës së formave të privatizimit në Kosovë, por edhe partitë tjera kanë lëvizur në të majtë të spektrit të përgjigjeve, përveç LDK-së e cila ka lëvizur në të djathtë.


Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Privatizimi	0.7	-1.1	←

AAK është më së afërti përgjigjes kundër privatizimit me koncesion por jo kundër formave tjera, PDK është kundër privatizimit me spin-off por jo kundër tjerave përderisa LDK ka lëvizur në të djathtë, në përkrahje të shumicës së mënyrave të privatizimit.

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Privatizimi	4.8	3.3	→

Marrë në tërësi, spektri politik ka lëvizur lehtë në të majtë dhe tërësia e përgjigjeve është më homogjene se më herët.

10. Investimet/ndihma e huaj




Me kalimin e kohës, spektri politik është bërë më i hapur ndaj kapitalit të huaj (2.9 krahasuar me 1.7 më herët) dhe tani të gjitha subjektet e shohin atë si gjë pozitive. PDK dhe LDK e shohin kapitalin e huaj si efekt pozitiv që do të ndihmojë Kosovën të ndërtojë një ekonomi të fuqishme përderisa VV dhe AAK e shohin atë si pozitive vetëm nëse shoqërohet me një ekonomi vendore të fortë.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Investimet / ndihma e huaj	1.7	2.9	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Investimet / ndihma e huaj	4.0	4.6	←

Elita politika është më e hapur ndaj kapitalit të huaj tani (2.9 krahasuar me 1.7) sesa më herët, por dallimet në opinione individuale janë më të mëdha.

11. Niveli i shpenzimeve publike




Krahas konsolidimit të shtetit dhe diskursit publik, është pritur edhe sentimentimi që Kosova duhet të rrisë shpenzimet për mbrojtje. Edhe pse edhe para 6 viteve të gjitha partitë ishin për shpenzime më të mëdha në mbrojtje, të gjitha partitë kanë lëvizur drejt shpenzimeve edhe më të larta, për 1-3 pikë. AAK dhe VV janë më të zëshmet për shpenzime më të larta përdërisa LDK dhe PDK janë më pak dhe e njëjta radhitje ishte edhe para 6 viteve.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Niveli i shpenzimeve publike	-4.5	-6.2	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Niveli i shpenzimeve publike	4.0	4.6	=

Spektri politik ka opinion më të theksuar tani se para 6 viteve se shpenzimet publike duhet rritur ndjeshëm, së paku për sektorin e mbrojtjes.

12. Subvencionet




Spektri politik ka lëvizur drejt qendrës sa i përket subvencioneve për prodhimet vendore. Përdërisa 6 vite më parë përgjigjet ishin të shpërndara nga -6.2 (VV) deri në -2.6 (LDK), tani shpërndarja është nga -5.7 (VV) deri në -4.7 (AAK) që do të thotë që të gjitha partitë kanë qëndrime pothuajse identike tani duke favorizuar që shteti të subvencionojë një pjesë të madhe të produkteve vendore.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Subvencionet	-3.8	-5.3	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Subvencionet	5.0	4.8	→

Në përgjithësi, spektri politik është më përkrahës për subvencionet për produktet vendore sesa në të kaluarën, dhe përgjigjet janë mesatarisht homogjene.

13. Subvencionet në bujqësi



Disponimi për subvencione në bujqësi është rritur ndjeshëm dhe tani te shumica e përgjigjeve (mesatarja prej 5.5). Para 6 viteve përgjigjet ishin afër -1 që korrespondon me përgjigjen: “Pak: qeveria duhet të ofrojë subvencione bujqësore të kufizuara siç po bën tani.” Tani është më afër përgjigjes se “dhënia e subvencioneve bujqësore është njëjtë si një ndihmë sociale; ul nxitjen e prodhimit; dhe duhet të jepet vetëm në raste të veçanta dhe vetëm për prodhim strategjik.”


Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Subvencionet në bujqësi	-0.4	5.5	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Subvencionet në bujqësi	4.6	3.9	←

Interesante që VV është më fuqishëm për subvencione në bujqësi duke qenë më afër përgjigjes “Qeveria duhet 100% të prioritetizojë bujqësinë duke marrë parasysh potencialin që e ka, në krahasim me sektorët tjerë të ekonomisë.”

Dimensioni ndërkombëtar

14. Bashkësia ndërkombëtare në vendimarrje




Është e natyrshme që të gjitha partitë kanë lëvizur drejt një roli më të vogël të bashkësisë ndërkombëtare, sepse ajo në Kosovë më nuk ka më rol mbikëqyrës siç ka qenë situata në të kaluarën.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Bashkësia ndërkombëtare	-1.4	-0.5	→

Gjithashtu dallimet në përgjigje janë zvogëluar nga devijimi standard prej 5.5 në 4.3.

15. Globalizimi




Është interesante se trendet globale kundër globalizimit nuk vlejné për Kosovë, ku duket se elita politike nuk është më anti-globaliste sesa para 6 viteve, përkundrazi. VV tani është qartazi pjesë e përgjigjeve me pikëpamje pozitive ndaj globalizimit si subjektet tjera si PDK dhe AAK përderisa LDK shfaq përkrahje edhe më të madhe ndaj globalizimit sesa më parë.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Globalizimi	2.0	3.0	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Globalizimi	4.5	5.2	←

Përderisa spektri politik ka lëvizur drejt një pikëpamjeje më pozitive të globalizimit, dallimet në përgjigje janë rritur, që shfaq mospajtime të ndjeshme brenda subjekteve.

16. Mjedisi



Të gjitha partitë janë për mbrojtjen e mjedisit, edhe pse kjo është në kundërshtim të plotë me politikat aktuale, ku i kushtohet shumë pak vëmendje prioritetive mjedisore. Përgjigja e LDK-së qëndron mes përgjigjes se “duhet të financojmë programe të ndryshme si dhe duhet që më shumë burime të alokohen për mbrojtjen e mjedisit, të cilat eventualisht do ta shpagojnë vetveten” dhe asaj të “ofrojmë ulje të taksave për ndotësit e vegjël, dhe të gjobisim ndotësit e mëdhenj”. Përgjigja e tri partive të tjera qëndron një shkallë më lart dhe dallon midis “uljes së taksave për ndotësit e vegjël dhe gjobitjeve më të mëdha ndotësit e mëdhenj” dhe “nevojës për të pasur një legjislacion të avancuar që do t'i detyronte ndotësit t'u përmbahen standardeve të BE-së”.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Mjedisi	5.6	8.9	→


Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Mjedisi	5.0	5.2	←

Është interesante të vërehet sa pro-ambient janë mendimet e klasës politike edhe pse nuk përkohet aspak me politikat e vendosura. Kjo është njëra nga dëshmitë se rezultatet që dalin shfaqin dëshirat e respondentëve por përderisa nuk janë ballafaquar me vendime të vështira, apo këto janë aq të kushtueshme dhe në dukje aq luks, saqë fare nuk arrijnë në agjendë për

vendimmarrje. Mesatarja ka lëvizur në të djathtë në mes të përgjigjes (8), **“Duhet të ofrojmë ulje të taksave për ndotësit e vegjël, dhe të gjobisim ndotësit e mëdhenj”** dhe përgjigjes (10) **“Duhet të sjellim legjislacion të avancuar për ambient dhe të detyrojmë të gjithë ndotësit që t'u përmbahen standardeve të BE”**.

17. Integrimi evropian

Para 6 viteve, të gjitha partitë ishin për integrimin evropian, edhe pse Vetëvendosje kishte rezerva të mëdha. Vlerësimi i saj prej 1.6 pikësh është më afër përgjigjes “Kundërshtoj: BE pengon shoqërinë duke rregulluar politikën fiskale (merr një kompetencë nga Kuvendi ynë) por mbase nuk kemi zgjedhje: Përgjigja e partive të tjera (që sillen prej 4.3 deri 4.9) është më afër përgjigjes “E përках: Por vetëm nëse procesi i integritimit në BE bëhet më efikas, transparent dhe i hapur”.



Më 2020, partitë gati që kanë ndërruar rolet tërësisht. VV ka lëvizur nga 1.6 në 4.7 duke e bërë atë partinë më pro-integritimit në BE. Partitë tjera në ndërkohë janë më pak entuziaste dhe të trijat kanë shënuar lëvizje në të majtë, veçanërisht PDK.


Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Integrimi Evropian	3.9	5.8	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Integrimi Evropian	3.9	3.8	→

Tërë spektri politik është më pro-evropian me mesatare të përgjigjes prej 5.8 që shfaq përgjigje në mes 5 një përкахje e vakët **“Përках: Integritimi në BE nuk është brenga kryesore në këtë moment, por mund të rezultojë në shoqëri më stabile dhe të fortë”** dhe 7 **“Përках: Evropa duhet të jetë një bashkim koherent i shteteve kulturalisht të ndryshme, duke festuar diversitetin si një ndjenjë të unitetit.”** Shpërndarja e përgjigjeve është mesatare që tregon një nivel mesatar të pajtimimit në mes të individëve të cilët i janë përgjigjur anketës.

Raporti me shtetin

18. Pensionet




Sa i përket pensioneve, tërë spektri politik ka lëvizur nga e majta drejt qendrës. Përderisa më 2014, VV ishte për një skemë jashtëzakonisht zemërgjerë të pensioneve, tani VV është në mes të skemës “pay-as-you-go” dhe skemës publike obligative siç ka Kosova tani, ndërsa as AAK nuk është larg këtij sentimentit. PDK favorizon një skemë publike përderisa LDK është më e hapur drejt tregut privat.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Pensionet	-3.5	-1.7	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Pensionet	3.2	3.0	→

Tani opinioni kolektiv është më afër përgjigjes me pikë 1 që preferon situatën ekzistuese si skemë publike të detyrueshme me skema alternative private. Dallimet në opinione nuk janë të mëdha dhe brenda partive ka pak dallime për këtë temë.

19. Ndhimja sociale




Sa i përket ndihmave sociale, VV është akoma partia më e majtë, por tani dallimi me subjekte tjera është zvogëluar sepse partitë tjera kanë lëvizur në të majtë duke preferuar rritje të ndihmave sociale.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Asistenca sociale	-4.7	-7.2	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Asistenca sociale	4.5	3.9	→

Shumica e respondentëve preferon përgjigjen e cila parasheh nivelin e njëjtë si tani të shpenzimit për ndihmat sociale, por **“të rritet shuma për përfitues, por të ulet numri i përfituesve.”** Dallimet e përgjigjeve brenda subjekteve janë të vogla.

20. Madhësia e administratës publike




Të gjitha partitë në Kosovë janë të vetëdijshme se administrata publike është tepër e madhe dhe favorizojnë zvogëlimin e saj. AAK ka qëndrim më të qartë për zvogëlimin e administratës, përcjellë nga VV, PDK dhe LDK.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Madhësia e administratës publike	3.5	3.8	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Madhësia e administratës publike	4.1	4.2	←

Mesatarja e përgjigjeve prej 3.8 është afër përgjigjes me vlerë 4 që thotë “Të ulet: Administrata publike duhet të zvogëlohet paksa; disa pozita duhet të evaluohen, por duhet të krijohen pozita të reja, kur tjerat mbyllen.”

21. Pushimet dhe festat zyrtare



VV përkrah zvogëlimin e ditëve të pushimit për 2-3 ditë, LDK dhe AAK kanë qëndrim se ditët të mbeten njësoj apo të zvogëlohen për 1, përderisa PDK konsideron se ditët e pushimit duhet të mbeten njësoj.


Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Pushim / festat zyrtare	1.8	1.9	=

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Pushim / festat zyrtare	3.4	2.6	→

Në përgjithësi, mesatarja prej 1.9 dëshmon se shumica e respondentëve janë për zvogëlim të ditëve të pushimit për 1 ditë.

Privat vs. Publik

22. Kujdesi privat apo publik shëndetësor?




LDK dhe AAK të cilët kishin anuar lehtësisht drejt sektorit privat në të kaluarën tani vlerësojnë se duhet mbështetur kryesisht tek ai publik, siç kanë vlerësuar VV dhe PDK gjatë tërë kohës.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Ofrimi i kujdesit shëndetësor privat vs publik	-1.3	-3.3	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Ofrimi i kujdesit shëndetësor privat vs publik	5.3	3.1	→

Edhe te shërbimet shëndetësore ka lëvizje në të majtë ku subjektet tani vlerësojnë se sektori publik duhet të ofrojë më tepër dhe më pak duhet të mbështetemi te sektori privat. Në krahasim me vitin 2014, ka konsensus më të lartë te shumica e respondentëve, që tregon një mosbesim te sektori privat.

23. Shpenzimet publike në shëndetësi?




Të gjitha partitë, sidomos VV dhe AK, vlerësojnë se duhet shpenzuar më tepër për buxhet për shëndetësinë publike.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Shpenzimet publike në shëndetësi	-4.7	-5.1	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Shpenzimet publike në shëndetësi	4.0	4.3	←

Konsensusi është i qartë se duhet shpenzuar më tepër për shëndetësinë publike edhe pse përgjigjet nuk janë në unison dhe ka llojllojshmëri të mendimeve.

24. Interesi individual vs kolektiv




Qasja ndaj individit apo kolektives është një nga indikatorët matës për të vlerësuar animin majtas apo djathtas. Tërë spektri politik anon drejt kolektives duke filluar nga AAK pasuar nga VV, LDK dhe PDK si subjekti që përveç kolektives vlerëson edhe individualitetin.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Interesi individual vs kolektiv	-4.4	-4.7	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Interesi individual vs kolektiv	6.0	5.9	→

Përgjigjet janë pothuajse të njëjta si më parë, me një lëvizje të lehtë drejt kolektives por ka mendime të ndryshme për këtë temë brenda dhe në mes të partive.

25. Publike vs. Private




Një pyetje e ngjashme tenton të masë opinionin e zyrtarëve të partive nëse mendojnë se ekonomisë së Kosovës më tepër i shërbejnë institucionet private apo ato publike. VV shfaq besimin më të lartë tek institucionet publike edhe pse më pak në vitin 2020 sesa në 2014. LDK ka lëvizuar nga një subjekt që i beson më tepër privateve te subjekti i dytë pas VV-së që i beson publikes. Tani PDK dhe AAK janë subjektet e qendrës së djathtë të cilat besojnë se institucionet private janë më efikase në përgjithësi.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Publike vs private	-0.2	-1.1	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Publike vs private	4.4	5.5	←

Pyetja paraprake erdhi te një gjetje e ngjashme dhe këtu njësoj shprehet preferencë e lehtë për publikën, në krahasim me 6 vite më parë. Gjithashtu, mospajtimet e mendimeve individuale dhe në mes të partive janë të ndjeshme.

26. Mësimi për religjionet




Ngurrimi ndaj mëimit fetar duket se i bashkon kosovarët e të gjitha shtresave dhe me kalimin e viteve pak ka ndryshuar. VV dhe PDK janë dy subjekte me qëndrime më të buta sa i përket disa formave të mëimit për të gjitha fetë dhe duke anuar më shumë kah përgjigja se “edukimi fetar duhet të jetë pjesë e edukimit të përgjithshëm për vlerat shoqërore dhe se nuk duhet të jetë kurs i veçantë”. AAK dhe LDK shfaqin më pak gatishmëri për mësim për fetë edhe pse nuk janë tërësisht kundër. ahasim me 6 vite më parë. Gjithashtu, mospajtimet e mendimeve individuale dhe në mes të partive janë të ndjeshme.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Mësimi për religjionet	3.0	2.6	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Mësimi për religjionet	3.6	2.3	→

Mesatarja e përgjigjeve, dhe për të cilën ka konsensus mjaft të gjerë, është më afër përgjigjes se “Edukimi për fetë të jetë pjesë e edukimit të përgjithshëm për vlerat shoqërore dhe nuk duhet të jetë lëndë e ndarë (jo lëndë veçantë por në kuadër të lëndës Edukatë Qytetare)”

27. Feja vs. shteti



Pothuajse të gjitha partitë janë të një qëndrimi dhe përgjigjet janë nga 2.5 (AAK) deri në 3.8 (LDK) që dëshmojnë se shumica e zyrtarëve që kanë plotësuar pyetësorin vlerësojnë se feja duhet respektuar, duhet rregulluar, nuk duhet ndihmuar nga shteti dhe duhet të jetë personale.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Feja vs shteti	2.7	3.1	→


Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Feja vs shteti	4.9	6.3	←

Edhe pse qëndrimet e shprehura janë në drejtim të sekularitetit, ka dallime të mëdha në opinione edhe brenda partive.

Aspektet ndëretnike

Përderisa VV-ja gëzon imazhin si partia më nacionaliste, përfaqësuesit e saj kishin mendimet më miqësore për multietnicitetin dhe marrëdhëniet ndëretnike. Përgjigjet e VV-së ishin më liberale, në të cilat shfaqej gatishmëria për të punuar me serbët e Kosovës, për të jetuar afër tyre por jo edhe për t'u martuar me ta. Zyrtarët e AAK-së ishin më së paku të gatshëm për marrëdhënie ndëretnike, ku mesatarja e përgjigjeve theksonin se nuk e kanë problem të jetojnë afër serbëve të Kosovës, madje edhe të punonin me ta. Përgjigjet e LDK-së dhe PDK-së sillëshin diku në mes. duhet respektuar, duhet rregulluar, nuk duhet ndihmuar nga shteti dhe duhet të jetë personale.

28. Marrëdhëniet ndëretnike




Zyrtarët e VV-së shfaqin qëndrime më tolerante ndaj grupeve tjera etnike, përcjellë nga LDK, PDK dhe së fundi AAK. Për VV-në dhe LDK-në, shumica e përgjigjeve tregojnë që pa problem mund të ndajnë një zyre dhe të kenë për fqinj pjesëtarë të grupeve tjera. Për respondentët e PDK-së dhe veçanërisht ata të AAK-së, përgjigjet ishin në mes të atyre që asnjëherë nuk do të punonin me një zyre apo të bashkëpunonin me një pjesëtar të një grupi tjetër dhe të atyre që nuk kanë këtë problem.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Marrëdhëniet ndëretnike	1.8	2.7	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Marrëdhëniet ndëretnike	4.5	4.8	←

Mesatarja e qëndrimeve për marrëdhëniet ndëretnike ka lëvizur drejt qëndrimit liberal dhe është më afër përgjigjes +3 me të cilin shihen marrëdhëniet ndëretnike si pozitive dhe se “Pa problem do të mund të punoja në një zyre apo të bashkëpunoja në ndonjë mënyrë tjetër me dikë nga minoritetet.” Brengos paksa fakti se janë rritur divergjencat për këtë temë dhe ka dallim të ndjeshëm në përgjigje brenda dhe në mes të partive.

29. Multietniciteti




Për aq sa kanë pasur rezerva për 'multietnicitetin' partitë më 2014, tani kanë fare pak. Të gjitha partitë kanë lëvizur në drejtim të opinionit që multietniciteti forcon shoqërinë kosovare, kryesuar nga VV, pasuar nga LDK, PDK dhe së fundi AAK, ngjashëm siç ishte radhitja edhe para 6 viteve.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Multietniciteti	2.0	4.5	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Multietniciteti	3.9	4.9	←

Në këtë anketë sivjet, mesatarja është 4.5, që e tejkalon përgjigjen me 4 pikë që thotë se **multietniciteti e forcon shoqërinë kosovare dhe** duhet të mbrohet në të gjitha format, dhe minoritetet nuk duhet të asimilohen në një kulturë ose fe të vetme të një shteti.

30. Trajtim preferencial i pakicave




Më 2014, të gjitha partitë u shprehën kundër trajtimit preferencial dhe shumica e tyre e mbështetën konstatimin se “trajtimi preferencial i minoriteteve është diskriminues për të tjerët” dhe se kërkesat e serbëve duhet të pakësohen me qëllimin që të jenë më të barabartë me të tjerët.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Trajtimi preferencial i pakicave	-3.6	-1.2	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Trajtimi preferencial i pakicave	5.8	4.8	→

Më 2020, të katër partitë e përfshira në anketë kanë lëvizur në drejtim më liberal dhe kanë më pak rezerva për trajtimin preferencial. Përgjigjet mbesin divergjente por më pak sesa para 6 viteve.

31. Imigracioni



Në pyetjen për imigracionin ka përafrim të qëndrimeve, VV është më liberale përderisa partitë tjera janë më shumë liberale dhe tani përgjigjen janë në mes 0.2 (LDK) dhe 3.6 (VV).

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Imigracioni	0.8	2.3	→


Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Imigracioni	4.3	3.0	→

Mesatarja e përgjigjeve prej 2.3 është më afër përgjigjes (+3): “Imigrantët jo-evropianë duhet të kenë të njëjtat mundësi të emigracionit si imigrantët evropianë” edhe pse kjo temë nuk ka testuar akoma elitën politike për të vërejtur nëse ky qëndrim do të bëhej edhe politikë zyrtare. Opinionet kanë konvergjuar me dallim më të vogël në mes të përgjigjeve individuale sesa në të kaluarën.

Qëndrimi ndaj të këqijave të shoqërisë

PDK dhe VV treguan nivelin më të ulët të mostolerancës ndaj bixhozit, bastoreve, prostitucionit dhe drogës. AAK-ja dhe LDK-ja ishin në favor të trajtimit të këtyre të këqijave shoqërore si të jashtëligjshme dhe për ndjekjen penale të tyre. Mendimet më të ashpra ishin për drogën, ndërsa më të butat ishin për lojërat e fatit dhe bastoret. Sa i përket prostitucionit shumica e përgjigjeve sillleshin rreth -5 pikëve që nënkupton “dekriminalizimin e saj (trajtimin si kundërvajtje) dhe të dënohet me gjobë”.

32. Bixhozi dhe bastoret



Mesatarja e përgjigjeve për bixhozin dhe bastoret nuk dallon shumë nga viti 2014, me një lëvizje të lehtë drejt konservatores. Partitë nuk kanë dallime të mëdha prirë nga AAK dhe VV me -2.7 pasuar nga PDK dhe LDK.


Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Bixhozi dhe bastoret	-2.0	-2.5	←

Më 2014, përgjigjet për bixhozin dhe bastoret ishin më të shpërndara (-3.5 deri më -1.0) dhe tani janë më të koncentruara (-2.7 deri në -1.9).

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Bixhozi dhe bastoret	4.6	4.9	←

Përgjigjet janë më divergjente tani me devijim standard prej 4.9 por edhe kjo nuk përbën dallim nga para 6 viteve.

33. Prostitucioni




Qëndrimet për prostitucionin kanë lëvizur në të majtë në drejtim konservator. AAK është partia më konservatore edhe pse edhe në këtë rast vlerësojnë se duhet të trajtohet si kundërvajtje që dënohet me gjobë. VV, PDK dhe LDK janë në mes të kësaj përgjigjeje dhe përgjigjes se edhe pse përbën kundërvajtje, prostitutat duhet të trajtohen si viktimë.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Prostitucioni	-4.2	-5.1	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Prostitucioni	6.7	7.7	←

Mesatarja prej 5.1 është më konservatore sesa që ishte 4.2 para 6 viteve. Tani të gjitha partitë janë më në të majtë sesa mesatarja e para 6 viteve. Por divergjencat në opinione janë rritur – dmth një pjesë e respondentëve janë tejet liberalë dhe një pjesë janë tejet konservatorë.

34. Drogat



Opinioni i elitës politike për narkotikët ka lëvizur paksa drejt drejtim konservator. AAK kishte qëndrimin më të ashpër para 6 viteve dhe tani ka qëndrim edhe më të ashpër. PDK ka lëvizur drejt një qëndrimi më të ashpër si partia e dytë më konservatore në këtë aspekt.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Drogat	-5.2	-5.9	←

Mesatarja e përgjigjeve është -5.9 që është më afër përgjigjes se “drogat përbëjnë kundërvajtje dhe duhet të ndëshkohen me gjobë” përderisa qëndrimi i AAK-së është afër -8 se drogat përbëjnë vepër penale dhe duhet të ndëshkohen.”


Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Drogat	4.2	4.4	←

VV kishte qëndrim më liberal para 6 viteve dhe tani është përafëruar me LDK-në në mes të përgjigjes -6 më lartë dhe asaj -4 që thotë të ndalohen drogat e rënda, por të ketë trajtim tjetër për drogat e lehta. Para 6 viteve, VV ishte afër përgjigjes +2 që disa nga narkotikët të jenë ligjore vetëm për arsye shëndetësore dhe të mund të merren vetëm me recetë të mjekut.

Liritë personale

VV vazhdon të jetë partia më liberale sa i përket lirive personale, por jo me dallim aq të madh nga partitë tjera sa ishte para 6 viteve. LDK dhe PDK janë më moderne dhe kanë ngushtuar hendekun me VV-në, përderisa AAK mbetet partia më tradicionale.

35. LGBT



Sa i përket lirive personale për temën LGBT, VV është më pak liberale sesa më parë përderisa PDK, AAK dhe LDK janë më liberale sesa më parë, edhe pse jo aq sa VV. Përderisa në vitin 2014 përgjigjet ekstreme ishin larg nga -4 deri në +3.9 tani ato konvergjojnë nga -1.8 deri në +1.63. Tërë spektri politik favorizojnë që të drejtat LGBT duhet lejuar por kryesisht të jenë të drejta private dhe mos të promovohen (partitë tjera) përderisa zyrtarët e VV-së janë paksa më liberale dhe përkrahin edhe promovimin por jo edhe me paradë.


Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
LGBT	-1.7	-0.1	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
LGBT	7.1	6.4	→

Mesatarja prej -0.1 qëndron në mes të përgjigjeve prej -1 se “E lejuar me ligj (për individ), por privatisht (jo promovim)” dhe +1: “E lejuar me ligj, por me shoqatën (mund të promovojnë, por jo paradë)”

Dallimet në mendime para 6 viteve ishin tejet të larta (7.1) që do të thotë se shumica e respondentëve ose ishin tejet përkrahës ose tejet kufizues për këtë pyetje. Sivjet dallimi ishte paksa më i ulët por sërish tregon që kjo është një nga pikat më kundërthënëse.

36. Aborti




Një indikator tjetër matës sa është një vend liberal është qëndrimi rreth abortit. Në këtë pikë, partitë kryesisht kanë lëvizur në drejtim konservativ. VV dhe AAK kanë pësuar lëvizjet më të mëdha në drejtim konservator përderisa PDK ka qëndruar në të njëjtin pozicion dhe LDK ka qëndrim më liberal. Si më herët, asnjë parti nuk është shprehur që aborti duhet të jetë i paligjshëm, por është brengosës qëndrimi i AAK-së i cili thekson se aborti duhet të jetë në parim i paligjshëm dhe të lejohet vetëm në raste të veçanta.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Aborti	-0.1	-2.3	←

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Aborti	4.2	3.7	→

Përgjigja mesatare prej -2.3 është në mes të përgjigjes -4 se “shërbimet e abortit duhet të financohen nga qeveria për gratë të cilat nuk mund t'i përballojnë ato shërbime” dhe përgjigjes -1 se “aborti duhet të jetë i lejuar me ligj; por të jetë i ofruar vetëm nëpërmjet institucioneve të financuara privatisht”.

37. Vlerat familjare




Një vistër pyetjesh kanë mëtuar të masin vlerat familjare (numri i fëmijëve, divorci, familjes së zgjeruar, bashkëjetesa, marrëdhëniet seksuale para martesës dhe rolit të gruas në shtëpi) ku VV mbetet subjekti më liberal, pasuar nga PDK dhe LDK. Të gjitha partitë kanë shënuar lëvizje në drejtim të vlerave liberale.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Vlerat familjare	3.2	4.7	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Vlerat familjare	4.7	4.4	→

Mesatarja prej 4.7 dëshmon që elita politike vazhdon në drejtim liberal dhe se përgjigjet kanë dallime mesatare brenda partive.

38. Shoqëria civile



Para 6 viteve, të gjitha kishin përgjigje pothuajse të njëjta sa i përket shoqërisë civile, të cilat sillleshin mes përgjigjes se “roli i shoqërisë civile nuk është shumë efektiv, ka shumë vend për përmirësime” (-1) dhe se “shoqëria


civile duhet të vazhdojë të jetë e inkurajuar, pasi krijon një komunitet më të përfshirë” (+1). Më 2020, opinioni në politikë mbi shoqërinë civile gëzon imazh më të mirë, veçanërisht te LDK, pasuar nga PDK, VV dhe AAK. Vlen të theksohet që lëvizja më e madhe është bërë nga PDK e cila ishte më skeptikja ndaj shoqërisë civile më parë dhe tani është afër LDK-së me opinion pozitiv për shoqërinë civile.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Shoqëria civile	0.6	1.8	→

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Shoqëria civile	5.1	5.2	←

Përgjigja mesatare prej 1.8 është më afër me përgjigjen prej 2 pikëve: Shoqëria civile duhet të vazhdojë të jetë e inkurajuar, pasi që krijon një komunitet më të përfshirë. Shpërndarja e opinionëve është mjaft e madhe (5.2) por dallimet janë brenda partive dhe jo në mes të partive.

39. Kultura dhe tradita




Në matjen para 6 viteve, LDK dhe AAK favorizuan një preferencë më të madhe për tradicionale (më afër pikëve prej -4 se “tradita duhet të kultivohet me fonde publike” dhe “0” “tradita dhe modernja duhet të balancohen me kujdes”). LVV dhe PDK anonin paksa më shumë kah modernja ashtu siç janë edhe tani. AAK vazhdon të mbetet më tradicionale përderisa LDK ka lëvizur drejt lirive individuale.

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Kultura dhe tradita	-0.8	-0.8	=

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Kultura dhe tradita	4.9	5.2	←

Mesatarja e përgjithshme ka mbetur njësoj dhe gjithashtu edhe shpërndarja e përgjigjeve e cila mbetet e lartë. Kjo tregon se ka dallime të mëdha të mendimeve brenda partive.

40. Pushimi i lehonisë



Partitë kanë qëndrime të njëjta sa i përket pushimit të lehonisë si më parë, ku shumica favorizojnë politikën e zgjatjes së pushimit në 9 muaj që paguhen nga sektori publik dhe 3 muaj nga punëdhënës privatë (-7 pikë).

Mesatarja e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Pushimi i lehonisë	-6.5	-6.5	=

Devijimi standard e tërë spektrit politik	2014	2020	Trendi
Pushimi i lehonisë	5.5	3.4	→

Përgjigjet këtë herë madje janë më homogjene dhe me dallime më të vogla në mes të respondentëve (3.4 pikë krahas 5.5 para 6 viteve).

Paraqitja e të gjitha temave njëkohësisht

Temat më poshtë një nga një janë paraqitur në tabelën më poshtë së bashku, në mënyrë që të paraqitet një tablo e tërësishme e qëndrimeve. Në këtë rast pyetjet janë radhitur në atë mënyrë që të fillojnë nga përgjigjet më të majta deri tek ato më të djathta. Vlerat janë ngjyrosur me nuanca të së kuqes (për përgjigjet nën zero) dhe me nuanca të së kaltërtës (për përgjigjet mbi zero). Kjo paraqitje mundëson për të krahasuar partitë jo vetëm në pyetje specifike por në përgjithësi, për të parë njëherit se ku ka konsensus dhe ku dallojnë partitë.

Është interesante të vërehen pyetjet nga mesit ku disa parti dallojnë nga tjerat, si p.sh. privatizimi apo aborti.

	Fushat	LDK		LVV		AAK		PDK	
		2014	2020	2014	2020	2014	2020	2014	2020
1	Pushimi i lehonisë	-5.9	-6.9	-8.1	-5.9	-6.0	-6.7	-5.9	-6.6
2	Asistenca sociale. Rritje, Zvogëlim/nivel i njëjtë	-2.7	-6.3	-8.6	-8.4	-4.0	-6.9	-3.6	-7.1
3	Drogat	-6.7	-5.0	-1.6	-4.8	-7.6	-7.9	-5.2	-5.8
4	Shpenzimet publike	-2.8	-5.0	-6.9	-7.3	-4.6	-7.6	-3.9	-4.9
5	Paga minimale	-2.7	-7.4	-6.0	-6.9	-1.7	-6.9	-4.4	-5.5
6	Kujdesi publik shëndetësor	-3.9	-4.4	-6.4	-6.5	-3.2	-5.3	-5.5	-4.2
7	Prostitucioni	-4.1	-4.5	-3.3	-4.9	-6.3	-6.4	-2.9	-4.9
8	Subvencionet	-2.6	-5.5	-6.2	-5.7	-3.3	-4.7	-2.9	-5.5
9	Interesi individual vs kolektiv	-3.8	-5.0	-6.4	-4.8	-3.9	-5.7	-3.3	-3.3
10	Sindikatat e punëtorëve	-2.7	-3.3	-7.5	-6.5	-4.3	-2.3	-2.3	-4.4
11	Krijimi i vendeve të punës	-1.6	-3.8	-4.8	-5.6	-1.2	-2.5	-1.1	-2.4
12	Pensionet	-2.2	-0.2	-5.5	-3.3	-2.9	-2.5	-3.4	-0.8
13	Rregullimi i tregtisë	-1.5	-3.4	-4.7	-3.6	-0.4	-1.5	-1.5	-2.5
14	Shëndetësia publike/private	-0.5	-2.6	-3.6	-3.7	0.5	-4.0	-1.4	-3.0
15	Bixhozi dhe bastoret	-3.5	-1.9	-1.7	-2.7	-1.8	-2.7	-1.0	-2.6
16	Trajtimi preferencial i pakicave	-1.7	-0.4	-4.0	-1.5	-3.9	-1.9	-3.2	-0.8
17	Akciza	-1.4	0.9	-4.7	-0.3	-3.2	-1.8	-3.4	-2.2
18	Legalizimi dhe kostoja e abortit	-2.4	-1.7	4.3	0.0	-1.1	-6.2	-1.0	-1.4
19	Tatimi i sheshtë apo progresiv	-0.3	1.9	-5.9	-3.8	-0.8	-0.7	-2.1	2.3
20	Përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare në vendimarrje	-0.3	0.2	-3.3	-1.1	-0.7	-0.9	-1.2	0.0
21	LGBT	-4.0	-0.9	3.9	1.6	-3.8	-1.8	-2.7	0.4
22	Kultura dhe tradita	-1.9	-0.2	0.9	0.2	-2.4	-2.2	0.3	-0.8
23	Publike vs private	2.2	-2.1	-5.9	-3.7	2.3	0.6	0.6	1.0
24	Privatizimi	2.7	4.3	-8.0	-7.1	3.3	-2.2	4.8	0.6
25	Rregullimi i detyrimeve doganore	1.7	0.9	-2.4	-1.0	2.2	-0.2	-0.2	1.0
26	Rritja ose zvogëlimi i TVSH-së	2.0	0.6	-2.9	0.7	2.2	1.5	-0.1	3.7
27	Deklarata për SHC në KS	0.4	2.7	0.4	1.8	0.8	0.3	0.2	2.5
28	Imigracioni	0.2	1.6	4.1	3.6	-1.0	2.2	-0.1	1.7
29	Pushimi dhe festat zyrtare	1.1	1.5	1.0	4.4	2.9	2.2	2.3	-0.6
30	Pikëpamjet mbi marrëdhëniet ndëretnike	1.2	3.9	4.1	4.7	-0.7	1.0	2.4	1.3

31	Investimet dhe ndihmat e huaja	1.4	4.0	0.7	2.5	1.6	1.5	3.0	3.6
32	Subvencionet në bujqësi	-0.1	4.5	-0.2	7.5	-1.1	5.9	-0.1	4.2
33	Globalizimi, pozitiv/negativ	4.2	4.7	-1.6	2.1	3.0	2.4	3.2	2.8
34	Mësimi i fesë në shkollat publike	2.8	2.6	1.5	2.0	3.6	3.8	4.2	1.9
35	Feja vs shteti	2.2	3.8	3.0	2.9	2.8	2.5	2.9	3.3
36	Multietniciteti forcon/dobëson shoqërinë	1.2	5.1	3.7	5.3	0.4	3.1	2.7	4.6
37	Rritja/zvogëlimi i vendeve të punës në administratën publike	3.7	2.9	2.3	4.2	4.5	5.2	3.4	2.9
38	Vlerat e familjes	1.5	4.4	6.9	6.4	1.0	3.2	3.5	4.9
39	Perkrah/Kundershtoj integrimin në BE	4.8	6.2	1.6	5.9	4.3	5.5	4.9	5.7
40	Mjedisi	4.0	8.9	5.9	9.5	5.9	8.0	6.6	9.1

V. Shpërndarja e përgjigjeve

Tabela në faqen në vijim paraqet devijimin standard të secilës përgjigje si mënyrë për të matur shpërndarjen e përgjigjeve në tabelë sipas çështjes së adresuar dhe sipas partisë. Kështu, shkalla e shpërndarjes së përgjigjeve tregon se çështja e adresuar është më kundërthënëse brenda partisë. Kjo nuk do të thotë se partitë nuk duhet t'i diskutojnë këto tema, përkundrazi, për temat për të cilat në të kaluarën ka pasur diskutime të shumta publike kishte konsensus me të madh.

Këto shifra paraqesin devijimin standard të përgjigjeve të subjektivit në fjalë. Sa më i lartë numri, do të thotë dallimet në mes të respondentëve të kësaj partie ishin më të mëdha, dhe sa më i vogël numri dallimet janë më të vogla. Do të thotë, për pikat me devijim standard më të ulët, partia ka homogjenitet më të lartë të qëndrimeve dhe për pikat me vlera të larta, ka mendime të ndryshme.

Me një vlerë të devijimit standard prej 3.9, VV është partia më homogjene në krahasim me partitë tjera. LDK dhe AAK kanë shfaqur përgjigje më homogjene më 2020 sesa më 2014 duke ulur devijimin standard të përgjigjeve për rreth 10%.

Mesatarja e DS	2014	2020
VV	3.9	3.9
LDK	5.0	4.6
AAK	5.1	4.7
PDK	4.8	4.9
	4.7	4,53

Sa i përket pyetjeve, tabela më poshtë paraqet devijimin standard që ndihmon të kuptohet shpërndarja e përgjigjeve për çdo parti në çdo pyetje. Pyetjet janë radhitur nga ato me homogjenitet më të madh të cilat janë shenjuar me ngjyrë të gjelbër për të ilustruar temat për të cilat ka konsensus brenda partive. Sa më poshtë të shkohet në tabelë janë temat për të cilat ka pasur dallime të mëdha në mendime, pra të cilat janë më kundërthënëse.

	Fushat	LDK		LVV		AAK		PDK	
		2014	2020	2014	2020	2014	2020	2014	2020
1	Mjedisi	5.0	2.9	2.2	1.1	4.1	3.3	3.0	1.9
2	Pushimi i lehonisë	4.1	1.5	2.0	3.6	3.9	2.8	3.5	2.4
3	Kujdesi publik shëndetësor	3.8	2.9	1.4	1.7	5.0	3.1	2.7	4.4

4	Rregullimi i detyrimeve doganore	2.8	4.3	3.7	4.0	3.8	4.1	3.6	2.4
5	Perkrah/Kunder shtoj integrimin ne BE	4.6	3.2	4.0	2.6	4.4	3.3	4.3	2.8
6	Pikëpamjet mbi marrëdhëniet ndëretnike	4.2	2.0	3.4	2.8	4.9	5.4	3.3	4.8
7	Investimet dhe ndihmat e huaja	4.7	3.9	2.7	1.7	5.5	3.6	4.6	4.5
8	Shpenzimet publike	4.6	3.6	3.1	2.8	4.6	3.7	4.4	4.6
9	Vlerat e familjes	5.8	3.6	2.5	3.0	6.0	3.8	4.9	2.6
10	Shëndetësia publike/private	4.6	4.7	2.6	3.8	4.2	3.8	4.4	5.0
11	Përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare në vendimarrje	4.2	5.0	3.2	3.2	3.8	3.3	5.1	5.5
12	Globalizimi, pozitiv/negativ	4.1	3.5	5.0	3.3	4.4	5.0	4.4	3.6
13	Asistenca sociale. Rritje, Zvogëlim/nivel i njëjtë	6.3	2.7	3.8	3.6	5.7	2.9	5.3	3.4
14	Subvencionet në bujqësi	3.6	4.3	5.5	3.1	5.4	3.9	3.8	4.3
15	Feja vs shteti	5.3	4.8	2.9	4.2	4.2	4.3	4.2	4.4
16	Tatimi i sheshtë apo progresiv	4.4	5.2	1.4	3.8	5.7	4.8	4.6	4.7
17	Deklarata për SHC në KS	3.6	5.5	4.2	4.6	4.7	5.2	3.1	4.5
18	Paga minimale	5.9	2.6	2.4	2.4	7.9	2.9	6.0	5.8
19	Rritja ose zvogëlimi i TVSH-së	4.6	5.7	4.9	0.0	4.8	5.7	4.4	5.8
20	Krijimi i vendeve të punës	5.5	4.7	4.4	1.7	4.9	4.8	4.7	5.6
21	Kultura dhe tradita	4.9	3.5	4.1	4.2	4.4	4.7	5.2	5.4
22	Rritja/zvogëlimi i vendeve të punës në administratën publike	5.0	5.8	4.2	3.7	4.9	4.2	4.4	4.5

23	Trajtimi preferencial i pakicave	4.5	4.2	3.7	4.7	4.9	5.3	4.9	5.1
24	Sindikatat e punëtorëve	5.1	4.4	3.3	4.0	5.4	5.5	4.4	5.9
25	Drogat	4.8	5.7	4.9	5.3	3.6	3.7	5.4	5.0
26	Mësimi i fesë në shkollat publike	5.9	5.3	2.3	4.7	5.1	6.2	4.8	4.6
27	Pushimi dhe festat zyrtare	4.4	3.7	6.4	4.1	5.6	4.0	5.4	5.3
28	Subvencionet	5.3	4.7	3.9	5.4	6.1	4.8	4.8	4.5
29	Publike vs private	5.1	6.5	3.2	5.2	4.6	4.8	4.7	5.5
30	Rregullimi i tregtisë	5.4	5.5	2.5	3.5	5.8	7.1	5.6	4.5
31	Interesi individual vs kolektiv	5.3	4.7	3.8	4.8	5.2	5.4	5.2	5.8
32	Imigracioni	4.8	5.9	3.8	3.5	6.0	6.2	5.4	5.2
33	LGBT	4.3	4.7	5.8	6.4	5.5	4.6	5.0	5.1
34	Akciza	5.3	3.0	5.9	6.3	4.7	6.4	4.7	5.7
35	Multietniciteti forcon/dobëson shoqërinë	5.1	4.3	7.5	4.4	5.4	5.0	5.3	5.5
36	Pensionet	4.6	6.7	5.0	6.4	5.1	5.8	4.9	6.2
37	Prostitucioni	7.1	6.7	5.0	5.0	5.2	5.4	7.0	6.3
38	Privatizimi	6.9	6.8	2.0	3.9	6.5	7.8	5.8	8.3
39	Legalizimi dhe kostoja e abortit	7.1	8.0	7.5	7.6	7.2	3.2	6.8	6.9
40	Bixhozi dhe bastoret	7.0	7.5	6.3	7.4	6.8	7.8	6.8	8.0

Vetëvendosje duket se e ka shkallën më të lartë të homogjenitetit në qëndrime, me një mesatare të devijimit standard prej 3.9, ndërsa partitë e tjera luhaten mes 5 dhe 5.1.

Nëse krahasohen temat, më pak kundërthënie kishte për temat si pushimi i lehonisë, detyrimet doganore, investimet dhe ndihmat nga jashtë (që gjenden në krye të listës). Këto janë çështje për të cilat përgjigjet ishin pak a shumë të njëjta. Dallime më të mëdha në përgjigjeve gjejmë për çështjet që kanë të bëjnë me prostitucionin, bixhozin dhe bastoret, dhe abortin. Për këto tri pyetje, të anketuarit kanë dhënë përgjigje që janë mjaft kundërthënëse brenda grupit. Për shembull, temat si mjedisi, pushimi i lehonisë etj gëzojnë pajtim të gjërë sepse përgjigjet dallojnë pak njëra nga tjetra brenda partisë.

Fushat	LDK		LVV		AAK		PDK	
	2014	2020	2014	2020	2014	2020	2014	2020
Mjedisi	5.0	2.9	2.2	1.1	4.1	3.3	3.0	1.9
Pushimi i lehonisë	4.1	1.5	2.0	3.6	3.9	2.8	3.5	2.4
Kujdesi publik shëndetësor	3.8	2.9	1.4	1.7	5.0	3.1	2.7	4.4
Rregullimi i detyrimeve doganore	2.8	4.3	3.7	4.0	3.8	4.1	3.6	2.4
Perkrah/Kundershtoj integrimin në BE	4.6	3.2	4.0	2.6	4.4	3.3	4.3	2.8
Pikëpamjet mbi marrëdhëniet ndëretnike	4.2	2.0	3.4	2.8	4.9	5.4	3.3	4.8
Investimet dhe ndihmat e huaja	4.7	3.9	2.7	1.7	5.5	3.6	4.6	4.5
Shpenzimet publike	4.6	3.6	3.1	2.8	4.6	3.7	4.4	4.6
Vlerat e familjes	5.8	3.6	2.5	3.0	6.0	3.8	4.9	2.6
Shëndetësia publike/private	4.6	4.7	2.6	3.8	4.2	3.8	4.4	5.0
Përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare në vendimmarrje	4.2	5.0	3.2	3.2	3.8	3.3	5.1	5.5
Globalizimi, pozitiv/negativ	4.1	3.5	5.0	3.3	4.4	5.0	4.4	3.6

Është me rëndësi të theksohet se çështjet për të cilat përgjigjet janë më pak të shpërndara janë diskutuar mjaft shumë në publik, andaj kemi një përafrim të qëndrimeve. Në pjesën e poshtme të tabelës janë çështjet të cilat nuk janë diskutuar aq shumë, dhe për të cilat pritet të ketë shumë debate në të ardhmen (shih tabelën më poshtë).


Fushat	LDK		LVV		AAK		PDK	
	2014	2020	2014	2020	2014	2020	2014	2020
LGBT	4.3	4.7	5.8	6.4	5.5	4.6	5.0	5.1
Akciza	5.3	3.0	5.9	6.3	4.7	6.4	4.7	5.7
Multiethniciteti forcon/dobëson shoqërinë	5.1	4.3	7.5	4.4	5.4	5.0	5.3	5.5
Pensionet	4.6	6.7	5.0	6.4	5.1	5.8	4.9	6.2
Prostitucioni	7.1	6.7	5.0	5.0	5.2	5.4	7.0	6.3
Privatizimi	6.9	6.8	2.0	3.9	6.5	7.8	5.8	8.3
Legalizimi dhe kostoja e abortit	7.1	8.0	7.5	7.6	7.2	3.2	6.8	6.9
Bixhozi dhe bastoret	7.0	7.5	6.3	7.4	6.8	7.8	6.8	8.0

Temat për të cilat ka mendime të ndryshme brenda partisë janë të shenjura me të kuqe. P.sh. për temën “bixhozi dhe bastoret”, përgjigjet mesatarisht dallojnë nga njëri respondent te tjetri rreth 7 herë më shumë sesa te “mjedisi” apo “pushimi i lehonisë”.

VI. Kategorizimi i partive

Për të zhvilluar një instrument sa më të saktë, D4D ka realizuar hulumtim të hollësishëm për qëndrimet e përqafulara nga grupimet e ndryshme ideologjike të demokracive liberale perëndimore. Botimi i parë para 6 viteve ka përshkruar shkurt profilet kryesore ideologjike për t'ia bërë më të lehtë lexuesve që mund të mos i dinë dallimet e vogla mes profileve të ndryshme. Aty përshkruhen shkurtimisht ideologjitë si vijon: socialiste, majtiste, e qendrës së majtë, e qendrës së djathtë, djathtiste, social demokrate, liberale, autoritare, nacionaliste, lirive individuale, dhe konservative. Varësisht prej njohurive, disa lexues mund ta shohin të dobishme që të lexojnë këtë pjesë të botimit të parë.

Atëherë janë analizuar modele të shumta, disa prej të cilave janë analizuar në botim, dhe është përzgjedhur Diagrami Alternativ i Nolan-it. Ky version i diagramit bën që skica të lëvizë në formë rotacioni në mënyrë që vektorët për liritë ekonomike dhe personale të paraqesin liri më të madhe në krye të diagramit, dhe liri më të vogël në fund të tij. E majta ekstreme dhe e djathta ekstreme paraqiten në të majtë dhe në të djathtë, përkatësisht, ndërsa ideologjia libertariane është në krye, dhe ajo statistike në fund.



Për nevoja të studimit, ne kemi modifikuar një version të diagramit alternativ të Nolan-it dhe e kemi përpiluar pyetësorin sipas tij. Diagrami i ndan mendimet politike të njerëzve në dy vektorë: liria ekonomike dhe liria personale, e cila prodhon një diagram dydimensional. Ky lloj diagrami mundëson paraqitjen vizuale të pikëpamjeve, si p.sh, perspektivën libertariane (liri e madhe personale dhe ekonomike) dhe perspektivën totalitare (liri e vogël personale dhe ekonomike).

Në këtë kapitull paraqiten gjetjet e anketës, këtë herë në format dydimensional, për partitë veç e veç. Boshti “x” paraqet pyetjet që kishin të bënin me çështjet ekonomike, ndërsa boshti “y” i paraqet përgjigjet për vlerat. Secila pikë në diagram përfaqëson një individ të anketuar, i cili ishte në pozitë relativisht të lartë në një prej katër partive më të mëdha në Kosovë. Për të shmangur kurthin e klasifikimit të një partie në një kuadrant të vetëm ideologjik, ne kemi zgjedhur të identifikojmë shpërndarjen e cila ilustron krahasimin ndërmjet dhe brenda partive.

Duke iu referuar diagramit në faqen në vijim del se rezultatet tregojnë një shpërndarje të drejtë ideologjike, ku mendimet shtrihen në të dy aspektet e orientimit, atij ekonomik (boshti x) dhe të vlerave (boshti y). Për ta kuptuar më mirë një shpërndarje të tillë ideologjike duhet të ndahen kategoritë brenda sistemit ekonomik dhe atij të vlerave.

VV

Lëvizja Vetëvendosje (VV) u themelua në qershor të vitit 2005 si nismë qytetare. Albin Kurti e ka udhëhequr lëvizjen që prej vitit 2005, e cila shpesh mbështet procese dhe politika më radikale në krahasim me partitë e tjera. Kurti e sheh demokracinë përfaqësuese si të pamjaftueshme dhe e mbështet demokracinë e drejtpërdrejtë.


Kurti e përshkruan VV-në si të majtë ose të qendrës së majtë, por e thekson faktin se për shkak të sistemit politik në Kosovë dhe rrethanave aktuale, është vështirë që partitë të identifikohen me ideologji të caktuar.

Sa i përket politikave ekonomike, VV është më e majtë sesa partitë e tjera në Kosovë edhe pse më 2020 vërehet se ka lëvizur ndjeshëm drejt qendrës. VV ka kundërshtuar fuqishëm privatizimin, ndërsa është për një rol më të madh të shtetit në ekonomi, çka e vendos VV në spektrin e ideologjive majtiste.

Intervistat e realizuara me zyrtarët dhe aktivistët e Vetëvendosjes tregojnë për një grup koherent të individëve të cilët janë të rreshtuar përkrah qëndrimeve zyrtare të partisë. Mesatarja e rezultateve të intervistave të


realizuara e vendosin VV-në në qendrën e majtë të përcaktimit ideologjik të partive politike por më afër qendrës sesa para 6 viteve.

Përgjigjet e Vetëvendosjes kanë një shpërndarje më të vogël sa i përket vlerave ekonomike sesa për liritë sociale dhe individuale. Ata janë majtistë sa i përket çështjeve ekonomike, konservatorë sa i përket pikëpamjeve politike dhe të hapur sa i përket atyre shoqërore.



LVV 2014-2020: kur e majtë dhe kur e djathtë?

■ Mesatarja 14-20 ■ Dallimi 14-20




Ekziston një dallim i dukshëm i mendimeve brenda partisë për çështje të ndryshme. Sa i përket pyetjes për investimet, ndihmat e huaja dhe tatimet e sheshta dhe progresive, të anketuarit e VV-së kanë përgjigje mjaft të njëjta (devijim standard mjaft të vogël i të anketuarve të VV-së). Dallimi sa i përket devijimit më të madh të të anketuarit e VV-së shfaqet sa i përket çështjeve si aborti apo shoqëria shumetnike.

Grafikoni i mësipërm shpjegon ku qëndron partia në përgjithësi për secilën temë, si pasqyrë që mund të krahasohet (shtyllat e gjelbëra). Shtyllat ngjyrë hiri shpjegojnë dallimin e partisë nga 2014 deri më tani, për të parë në cilat fusha ka lëvizur në të djathtë dhe për cilat në të majtë, duke filluar nga temat ku partia është më e djathtë të fushat ku partia është e majtë.

LDK

LDK-ja në spektrin politik zë vend kryesisht si parti e qendrës së djathtë e cila është për një kombinim të liberalizmit ekonomik dhe konservatizmit social. Kjo demonstron përmes anëtarësimit të LDK-së në Partinë Popullore Evropiane (EPP) e cila identifikohet si familja politike e qendrës së djathtë.

Për LDK-në mund të thuhet se është pak më shumë liberale sesa partitë e qendrës së djathtë kur kemi të bëjmë me çështjet ekonomike. Në aspektin social, LDK-ja e përshkruan veten si konservatore, edhe pse mban pozicionim individualist në fushën e të drejtave të njeriut, duke e theksuar barazinë “pa marrë parasysh gjininë, moshën, përkatësinë etnike dhe fenë”. Deri vonë, LDK shihej si parti tradicionale që kontrollohet prej gjeneratave të politikanëve më të vjetër, por qeveria e fundit i ka dhënë përgjegjësi të mëdha për lidërsip aktivistëve të rinj.




LDK-ja e përkrah fuqishëm privatizimin e ndërmarrjeve publike, por, sikur partitë e tjera, nuk e ka kundërshtuar ofrimin pa pagesë të kujdesit shëndetësor.

LDK kryesisht ka mbetur siç ka qenë por ka një dyndje të lehtë të përgjigjeve kah qendra duke e bërë partinë më liberale dhe më të koncentruar rreth qendrës. LDK-ja gjendet më shumë në të djathtë të qendrës kur është fjala për çështjet ekonomike dhe më konservatore për çështjet sociale dhe politike. Vlerat individuale e rreshtojnë elitën tradicionale të LDK-së (e cila është zvogëluar më 2020) kundër një grupi më të madh liberal (të cilët duket të kenë mendime mjaft të kundërta).

LDK 2014-2020: kur e majtë dhe kur e djathtë?

■ Mesatarja 14-20 ■ Dallimi 14-20



Grafikoni i mësipërm paraqet mesataret (me të gjelbër) e përgjigjeve të LDK-së më 2014 dhe 2020, dmth të një tërësie prej rreth 70 përgjigjeve si qëndrojnë për tema të ndryshme, filluar kryesisht nga përgjigjet më liberale (si mjedisi) deri tek ato më të majta si pushimi i lehonisë, asistenca sociale apo paga minimale.

Me ngjyrë hiri paraqitet dallimi më i madh nga 2014 deri më 2020, duke paraqitur edhe vizuelisht pyetjet për të cilat është lëvizur në të djathtë apo në të majtë. Për shembull për mjedisin, subvencionet në bujqësi, apo LGBT ka lëvizje të mendimeve të theksuara në të djathtë. Për disa tema LDK ka lëvizur në të majtë, si p.sh. tani me preferenca më të mëdha për publikën, për pagën minimale dhe asistencën sociale.

PDK


PDK-ja kryesisht përkufizohet si parti e qendrës së djathtë në spektrin politik dhe ka një kombinim të politikave liberale në aspektin ekonomik, por edhe atyre konservatore në aspektin social; për shembull, përkrahja e tregut të lirë dhe tatimeve të ulëta, si dhe ruajtja e vlerave tradicionale. PDK-ja po ashtu ka pasur tendenca të herëpashershme drejt së majtës. PDK-ja, për kohë të shkurtër, ka asocuar veten si social demokrate dhe ka mbajtur lidhje me Partinë Laburiste (e Punës) të Mbretërisë së Bashkuar si dhe me Partinë Demokratike në SHBA.

Gjatë qeverisjes së saj, PDK-ja ka shfaqur tipare të ideologjive të kundërta. Në njërën anë kishte mbështetur privatizimin e ndërmarrjeve publike që është politikë e djathtë dhe në anën tjetër qeverisja e PDK-së subvencionoi bujqësinë dhe krenohet me politika të rishpërndarjes së që janë tipare të së majtës.

Pikat e kaltërta të plota paraqesin përgjigjet e vitit 2020, përderisa pikat kaltër jo të plotë paraqesin përgjigjet e vitit 2014. Mund të vërehet një grumbull përgjigjesh më liberale sa i përket vlerave sociale. Vërehet një koncentrim i përgjigjeve në përgjithësi, veçanërisht sa i përket boshtit ekonomik. Tani ka më pak përgjigje të djathta dhe të majta dhe shumica janë afër boshtit zero.

Busulla ideologjike e Kosovës


Evolucioni i orientimit partiak 2014-2020,
Vlerat dhe Popullizmi



Përgjigjet në PDK janë gjithashtu më pak të majta dhe më afër qendrës. Tani vërehen dy grupacione: një grupacion lehtësisht i majtë dhe konservator dhe një grupacion liberal dhe lehtësisht i djathtë. Në përgjithësi, përgjigjet e majta janë reduktuar ndjeshëm dhe ka koncentrim të përgjigjeve te mesi i spektrit.

PKD 2014-2020: kur e majtë dhe kur e djathtë?


■ Mesatarja 14-20 ■ Dallimi 14-20



Grafikoni i mësipërm tregon se PDK ka lëvizur drejt të majtës sa i përket temave si drogat apo prostitucioni, por edhe për pushimin e lehonisë dhe shpenzimet publike. PDK ka lëvizur në të djathtë për integrimin në BE dhe administratë publike.

AAK

AAK-ja konsiderohet po ashtu se i takon qendrës së djathtë edhe pse anketa e fundit vëren që e djathta e AAK-së ka lëvizur drejt qendrës dhe të majtës. AAK tradicionalisht ka përkrahur metodat e djathta ekonomike, por së paku mendimet brenda nuk përkojnë me këtë qëndrim më si më parë.



AAK 2014-2020: kur e majtë dhe kur e djathtë?

■ Mesatarja 14-20 ■ Dallimi 14-20




Në vitin 2020, siç shihet më lart në grafikonin dydimensional, AAK ka lëvizur qartazi në të majtë, duke ndarë një segment ideologjik të ngjashëm me VV-në.

Mendimet e elitës së AAK-së gjenden kryesisht në qendër, lehtë në të majtë të PDK-së dhe LDK-së kur bëhet fjalë për çështjet ekonomike, si dhe lehtë më konservatore se këto dyjat sa i përket lirive individuale.

AAK është e djathtë kryesisht për të njëjtat tema si partitë tjera por edhe për tema që tjerët nuk janë aq të djathtë si 'vlerat e familjes'. AAK është e majtë për temat e ngjashme si partitë tjera.


VII. Sa janë homogjene partitë?

Grafikonet e partive në kapitullin më herët ilustronjë shpërndarjen e të gjithë të anketuarve. Grafikoni më poshtë krahason të gjitha partitë më qartë se çfarë përqindje e tyre del në cilin kuadrant.




Nëse analizojmë shpërndarjen e secilës parti nëpër kuadrantet ideologjike, del se VV nuk ka pothuajse asnjë aktivist libertarian që është e natyrshme sepse edhe në qëndrimet e tyre nuk shfaqin këso qëndrime. Në kapitullin e mëhershëm vërehet se pjesa më e madhe dalin në kuadrantin statist, dmth të majtë ekonomikisht dhe konservatorë në aspekt të lirive individuale.

LDK qartazi është parti me përqindjen më të lartë të zyrtarëve që përkrahin liritë individuale dhe është e barabartë me PDK-në sa i përket lirive ekonomike. AAK është parti e dytë më konservatore pas VV-së dhe e treta sa i përket lirive ekonomike pas LDK-së dhe PDK-së.



Diagrami i mësipërm paraqet të gjitha partitë në një vend me qëllim që të krahasohen më lehtë vizuelisht. Ky grafikon dëshmon se partitë kanë elektorat të përzier që ka gjasa që më tepër pajtohen për shumë tema me aktivistë të partive tjera sesa me bashkëpartiakët e tyre.

Nëse partitë kosovare do të riorganizoheshin nëpër grupe që mendojnë ngjashëm për tema të ndryshme të politikave publike, rezultatet mund të dukeshin si më poshtë. Në këtë situatë hipotetike, Kosova do të kishte dy parti të mëdha, një të qendrës dhe një populliste konservatore, si dhe dy parti të vogla, një liberale dhe një parti social-demokrate.



Përfundime dhe rekomandime

Në përgjithësi, D4D përdori veglën e njëjtë studimore si para 6 viteve në mënyrë që të nxjerrim jo vetëm studimin si fotografi e çastit por edhe krahasimin kohor. Nga studimi del se akoma nuk mund të themi që kemi parti të cilat janë të profilizuara qartë. LDK ka mbetur parti e qendrës së djathtë dhe ka përgjigjet më të koncentruara. Të njëjtën hapësirë të spektrit tani zë edhe PDK e cila gjithashtu ka përgjigjet më pak të shpërndara dhe më të koncentruara.

AAK dhe VV janë përafuar, njëra nga e djathta drejtë qendrës së majtë konservatore dhe tjetra nga e majta në drejtim të qendrës së majtë, gjithashtu konservatore, dhe tani ndajnë spektrin e njëjtë ideologjik.

Siç është konkluduar para 6 viteve, në Kosovë akoma vlen maksima se për t'i fituar zgjedhjet në Kosovë më shumë ndihmon mos-deklarimi sesa pozicionimi i qartë që gjithashtu sjell edhe armiq. Pas çdo deklarate specifike, politikanët fitojnë më shumë armiq sesa votues. Rrjedhimisht, më mirë u del atyre që nuk deklarohen konkretisht dhe kjo kulturë politike duhet ndryshuar.

Kosova vazhdon të përballet me situata krize, politike të polarizuar dhe sfida ekzistenciale pasi që ndjehet që ka sovranitet të brishtë duke mos qenë anëtare e OKB-së.

Edhe pse ka mbi 10 vite që Kosova qeveris veten, pak tema depërtojnë në agjendë të vendimmarrësve për shkak që dialogu dominon tërë agjendën dhe vendimet tjera merren si teknike me automatizëm, si pjesë e harmonizimit të legjisllacionit me BE-në. Rrjedhimisht, elitës politike nuk i imponohet që të deklarohet për tema të ndryshme, përfshirë ato të cilat i kemi matur me këtë studim.

Sidoqoftë, sa më shumë cikle të zgjedhjeve që kalojnë, përfaqësuesit e zgjedhur sado pak do të deklarohen për pozicionet e tyre. Shpresojmë që një punim si ky të shtyjë publikun që të kërkojë qartësi të pozicioneve, dhe të shtyjë politik-bërësit modernë që të fitojnë votues të rinj pikërisht duke qartësuar qëndrimet e tyre.

Partitë mund të fitojnë shumë nga një studim i tillë sepse kuptojnë si ndjehen zyrtarët e tyre për tema për të cilat me gjasë nuk i vie radha të diskutohen brenda radhëve të tyre apo në Kuvend, sa dallojnë partitë mes vete, sa

dallojnë zyrtarët brenda një partie, si dhe sa dallojnë pozicionet reale nga deklaratimet e partive, nga qëndrimet e qytetarëve apo nga realiteti evropian tek i cili mëtojmë të lëvizim.

Me zhvillimin gradual të vendit, është legjitime të presim që me përmbylljen e nevojave imediate (furnizimi me ujë, kanalizimi, infrastruktura themelore), kosovarët do të kenë pritje më të mëdha.

Viteve të fundit, kosovarët kanë themeluar me dhjetëra organizata ku nënat bashkohen për të lobuar bashkërisht, ashtu si bëjnë edhe gjeodetët apo prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ata kërkojnë parti apo deputetë individualë që kanë qëndrim të qartë dhe që e mbështesin kauzën e tyre.

Botimi i parë i këtij studimi kishte për qëllim të përcaktonte vlerën numerike të qëndrimeve, dhe pastaj të maste shpërndarjen e brendshme në secilën parti. Përveç kategorizimit të partive politike, ky publikim edhe ka kontribuar për të zbërthyer se çfarë e përkufizon të djathtën dhe/ose të majtën në përgjithësi dhe në Kosovë në veçanti.

Ky botim tutje sjell dy risi. Së pari sjell krahasimin me një distancë kohore prej 6 viteve. Nga një fotografim i gjendjes më 2014, tani mund të shohim gradualisht lëvizjet dhe trendet. Ky punim nuk ka hyrë në tentime për të shpjeguar arsyet e këtyre lëvizjeve në mënyrë që të mos shihet si anim potencial.

Risia e dytë e këtij punimi është se shikon koncentrimin e përgjigjeve. Vërehet që përgjigjet janë më të koncentruara sesa vite më parë dhe mund të jetë se partitë kanë pasur kohë të debatojnë temat dhe tani pozicionet janë më homogjene sesa në të kaluarën.

Rekomandime

Partitë të hartojnë qëndrime zyrtare për tema të ndryshme të cilat paraqiten nga organet partiake, pavarësisht a janë në qeveri apo jo. Duhet organizuar bisedime të brendshme, në mënyrë që partia të jetë e përgatitur për tema të ndryshme kur të vijë në pushtet. Nuk është i domosdoshëm profilizimi formal, por është më me rëndësi që të inicohet një proces dialogu brenda në mënyrë që do të shërbente edhe për përafrim dhe zhvillim të përgjigjeve ndaj problemeve të shumta shoqërore. Në këtë mënyrë, anëtarësia dhe personeli do të zhvillonin edhe ekspertizë për tema të ndryshme që ndihmon në debate dhe për të fituar përkrahje më të madhe në popull. Secilës parti i duhen mekanizma të brendshëm të komunikimit dhe edukimit politik që do të ndikonin në homogenizimin e qëndrimeve brenda strukturave të tyre.

Referencat

¹Anna Lührmann and Sebastian Hellmeier, Populism, Nationalism and Illiberalism: A Challenge for Democracy and Civil Society, Heinrich Böll Foundation, February 2020, https://www.boell.de/sites/default/files/2020-03/E-Paper_Populism_Nationalism_and_Illiberalism.pdf?dimension1=division_ip

²Cas Mudde and Cristóbal Rovira Kaltwasser, "Populism: A Very Short Introduction," (New York, NY: Oxford University Pres).

³Gottfried, Paul Edward. 2005. The Strange Death of Marxism: The European Left in the New Millennium. Columbia: University of Missouri Press. http://www.encyclopedia.com/topic/Left_Wing.aspx

⁴Briggs, William. April 2010. "The Pournelle vs. Nolan Chart: Political Throwdown." Web. <http://wmbriggs.com/blog/?p=2265>

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

329(496.51)“2014/2020”

Busulla ideologjike e Kosovës : evolucioni i orientimit
partiak 2014-2020, vlerat dhe popullizmi / përgatitur nga Instituti D4D. - Prishtinë:
Demokraci për zhvillim (D4D), 2021. - 76 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-823-04-3

ISBN 978-9951-823-04-3



Demokracia për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010, me vizionin se demokracia është parakusht i zhvillimit. Themeluesit e D4D besojnë se demokracia është mjet dhe qëllim për zhvillim dhe janë përkushtuar që të hulumtojnë dhe të përfshijnë një komunitet më të gjerë drejt këtij qëllimi.

Misioni i D4D është të ndikojë në zhvillimin e politikave publike në mënyrë që të përshpejtohet zhvillimi socio-ekonomik i Kosovës, të përmirësohet qeverisja dhe të forcohet kultura demokratike në vend.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org.

Busulla ideologjike e Kosovës

Evolucioni i orientimit
partiak 2014-2020,
Vlerat dhe Popullizmi

Instituti Demokraci
për Zhvillim

Seria:
Partitë Politike

Nr. 15

Prishtinë,
Dhjetor 2020



Busulla ideologjike e Kosovës



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Evucioni i orientimit
partiak 2014-2020,
Vlerat dhe Popullizmi

Instituti Demokraci
për Zhvillim

Seria:
Partitë Politike

Nr. 15

Prishtinë,
Dhjetor 2020